




AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

RAPORT VJETOR

Agjencia Kosovare e Privatizimit

2018

Mars 2019



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

RAPORT VJETOR

2018

I AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT
PËR KUVENDIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

PËRMBAJTJA

FJALA HYRËSE E KRYESUESIT TË BORDIT TË AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	7
1.1.TË ARRITURAT KRYESORE.....	7
1.2.SFIDAT DHE PENGESAT.....	7
2. KORNIZA LIGJORE.....	8
3. PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT.....	9
3.1.MISIONI DHE VIZIONI	9
3.1.1. MISIONI.....	9
3.1.2. VIZIONI.....	9
3.2 KOMPETENCAT E AGJENCISË SIPAS LIGJIT.....	9
4.FUSHËVEPRIMI QË MBULON AGJENCIA.....	10
4.1. BORDI I DREJTORËVE.....	10
5.DEPARTAMENTI I SHITJES	11
6. NJËSIA E MONITORIMIT, KONTROLLËS DHE ADMINISTRIMIT DIREKT.....	12
6.1.SPIN OFF-ET SPECIALE.....	12
6.2.SPIN OFF-ET ME KUSHTE TË VEÇANTA	13
6.3.ADMINISTRIMI DIREKT.....	14
6.4.NDËSHKIMET FINANCIARE.....	15
7. DEPARTAMENTI I LIKUIDIMIT.....	16
7.1. LIKUIDIMI I NDËRMARRJEVE SHOQËRORE	16
7.2. OFRUESI I SHËRBIMEVE PROFESIONALE.....	17
7.3 SHPËRNDARJA E MJETEVE NDAJ KREDITORËVE.....	18
7.4. LIKUIDIMI I NDËRMARRJEVE SHOQËRORE PA ASETET DHE/OSE PA KËRKESA KREDITORE.....	18
7.5. NJËSIA PËR TRANZICIONIN E TREPÇËS.....	20
8. DEPARTAMENTI I KOORDINIMIT RAJONAL.	21
8.1. SHITJA DHE ADMINISTRIMI I ASETETEVE.....	21
8.2. ADMINISTRIMI I ASETETEVE.....	22
8.3.ASETET E LËSHUARA ME QIRAE.....	25

8.4. TRAJTIMI I ASETVE TË UZURPUARA.....	25
8.5. PËRCAKTIM I STATUSIT TË NSH-ve.....	25
8.6. QIRADHËNIA E PRONAVE TË NSh-ve	25
9. DEPARTAMENTI I LIGJOR	25
10. DEPARTAMENTI I MARKETINGUT, MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN DHE INVESTITORËT.....	26
11. DEPARTAMENTI I BURIMEVE NJERËZORE.....	27
11.1. REKRUTIMET DHE LËVIZJET E STAFIT.....	27
12. DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS.....	27
12.1. NJËSIA E SHKRESAVE GJYQËSORE.....	27
12.2. NJËSIA E PËRKTHIMEVE.....	27
12.3. NJËSIA E PROTOKOLLIT.....	28
12.4. NJËSIA E TEKNOLOGJISË INFORMATIVE.....	28
12.5. NJËSIA E ARKIVIT.....	28
12.6. NJËSIA E SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME.....	28
12.7. NJËSIA E TRANSPORTIT	28
13. DEPARTAMENTI I FINANCAVE DHE BUXHETIT.....	29
13.1. FINANCIMI I AKTIVITETEVE OPERATIVE DHE ADMINISTRATIVE TË AKP-së.....	29
13.2. PROCESI I FONDEVE NË MIRËBESIM – NDËRMARRJET SHOQËRORE.....	30
14. DEPARTAMENTI I PROKURIMIT.....	31
15. DEPARTAMENTI I KOMISIONEVE PROFESIONALE.....	31
15.1. KOMISIONI PËR SHQYRTIMIN E LISTAVE TË 20% TË PUNËTORËVE.....	31
15.2. KOMISIONI PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE NDAJ LISTAVETË 20% TË PUNËTORËVE.....	31
15.3. KOMISIONI PËR SHQYRTIMIN E ASETVE ME KARAKTER SPECIFIK.....	31
15.4. KOMISIONI PËR NEGOCIM DIREKT	31
15.5. KOMISIONI PËR CAKTIMIN E STATUSIT TË NDËRMARRJEVE – KPS.....	31
15.6. KOMISIONI PËR SHITJEN E BANESAVE NË PRONËSI SHOQËRORE	32
16. NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM.....	32
17. REKOMANDIMET PËRMbledhëse për të ardhmen.....	34
18. RAPORTI I ADRESIMIT TË REKOMANDIMEVE NGA ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT PËR AUDITIMIN E VITIT 2017	35
19. STRUKTURA ORGANIZATIVE E AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT.....	38
20. SHTOJCAT E RAPORTIT VJETOR TË AKP-së.....	39

FJALA HYRËSE E KRYESUESIT TË BORDIT TË AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Agjencia Kosovare e Privatizimit, themeluar nga Kuvendi i Kosovës, përbën një nga institucionet kyçe të infrastrukturës institucionale ekonomike në vend. Mandati i saj është drejtpërdrejtë i lidhur me zhvillimin e një ekonomie bashkëkohore të tregut, ku përmes procesit të transformimit të pronës shoqërore, Agjencia ndikon në fuqizimin e sektorit privat, bartës kryesor i zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik.

Pas emërimit të anëtarëve të Bordit të Drejtorëve në Maj të vitit 2018, si dhe përzgjedhjes të Drejtorit Menaxhues, Agjencia ka arritur që të krijojë dhe implementoj strategji nëpërmjet të cilave ka arritur të përmbushë objektivat të cilat ndikojnë në përmirësimin e imazhit, transparencës dhe rritjen e efikasitet të procesit të transformimit të pronës.

Angazhimi në përmbushjen e objektivave ka rezultuar në realizimin e planit të shitjes të aseteve në periudha mujore për kohën kur ka pas Bord funksional, shpërndarjen e mjeteve për kreditorët e Ndërmarrjeve Shoqërore dhe shpërndarjen e 20%-it të punëtorëve. Agjencia poashtu ka arritur të ec përpara me procesin e transformimit të pronës përmes shitjes me negociata direkte. Ndër sfidat më të spikatura gjatë vitit 2018 ishte edhe procesi i bartjes së pronës shoqërore tek komunat nga Qeveria, proces ky që është pezulluar deri në marrjen e vendimit nga Gjykata Kushtetuese.

Agjencia gjatë vitit 2018 ka nënshkruar Memorandumin e mirëkuptimit në mes të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë si dhe Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike lidhur me pjesëmarrjen e përbashkët në promovimin e ndërmarrjeve/aseteve shoqërore në formë të projektit për investime strategjike brenda dhe jashtë vendit.

Ndër vendimet më të rëndësishme janë bartja e fonde të mbetura në shumë prej 42,159,638.15€ dhe fonde të përkohshme në shumë prej 43,920,006.62€ në Fondin e Konsoliduar të Republikës së Kosovës.

Agjencia falënderon të gjitha institucionet në nivelin lokal dhe qendror për mbështetjen e dhënë në përmbushjen e objektivave të përbashkëta, duke shpresuar që ky bashkëpunim të vazhdojë dhe të rritet edhe më tepër në të ardhmen. Për më tepër, jemi të inkurajuar nga korrektësia e investitorëve karshi procesit të shitjeve, si dhe ish-punëtorëve të ndërmarrjeve shoqërore për mirëkuptimin e treguar. Vazhdimi i bashkëpunimi me të gjithë këta aktorë është jetik në përmbylljen e suksesshme të mandatit të Agjencisë.

Raporti në vijim përmban të gjitha rezultatet, planet e punës për vitin 2019, sfidat dhe pengesat si dhe rekomandimet për tu adresuar në vijim. Agjencia përkushtuar të vazhdojë angazhimin maksimal në përmbushjen e objektivave strategjike për përmbylljen e e suksesshme të punës së saj në një periudhe optimale.

Sinqerisht,

Sinqerisht,



Bajram Zejnullahu

Kryesues dhe Drejtor

Bordi i Drejtorëve

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në këtë raport është paraqitur një përmbledhje e shkurtër e punës së AKP-së për periudhën deri më 31 Dhjetor 2018 për punën e departamenteve dhe njësive tjera organizative, raport i cili i dorëzohet Kuvendit të Kosovës sipas nenit 20 të Ligjit të AKP-së. Ndërsa çështjet financiare janë të prezantuar dhe shpalosur në pasqyrat financiare të Fondeve në Mirëbesim dhe Të Hyrat e Dedikuara.

Andaj, jemi fokusuar në pika të shkurtër në këtë raport lidhur me këto fusha:

- Të arriturat kryesore;
- Administrimi dhe Shitja e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore;
- Pagesat për punëtorët e Ndërmarrjeve Shoqërore (20%);
- Shpërndarja e mjeteve ndaj kreditorëve për Ndërmarrjet Shoqërore;
- Aktivitetet operative dhe administrative të AKP-së; dhe
- Përmbledhje lidhur me financat.

1.2. TË ARRITURAT KRYESORE

- Realizimi i shitjeve të aseteve në baza mujore;
- Aprovimi i raporteve për shpërndarjen e mjeteve ndaj kreditorëve për 15 Ndërmarrje Shoqërore. Ndërsa, pagesat e realizuara deri më 31 Dhjetor 2018 janë gjithsej EUR 2,339,526 (duke përfshirë pagesat e ekzekutuara edhe për vitin paraprak);
- Shpërndarja e 20% për punëtorët e Ndërmarrjeve Shoqërore EUR 6,994,554 për 11,547 punëtorë;
- Rritja e efikasitetit në administrimin, kontrollimin dhe monitorimin e NSH-ve, Spin-Off-et speciale dhe privatizimeve me kushte;
- Trajtimi i aseteve të uzurpuara apo të shfrytëzuara pa bazë ligjore nga palët e treta;
- Rritja e inkasimit të qirasë prej 8.67% në krahasim me vitin 2017. Për periudhën Janar - Dhjetor 2018 janë inkasuar shuma prej EUR 6,268,014;
- Bashkëpunimi me institucionet në nivel qendror dhe lokal.
- Identifikimi i 22 aseteve të reja.
- Kthimi i pronave në pronësi të NSH-ve me vendime të gjykatave.

1.2. SFIDAT DHE PENGESAT

Sa i përket sfidave dhe pengesave, më poshtë kemi paraqitur faktorët e jashtëm të cilat kanë një rol kyç në administrimin më të mirë të aseteve, shitjen, likuidimin e tyre, dhe mbarëvajtjen e aktiviteteve operative dhe administrative. Faktorët që kanë ndikuar dhe do të ndikojnë në periudhat pasuese janë paraqitur si më poshtë:

- **Kuvendi i Kosovës** - Luan një rol kyç në proceset e AKP-së.
 - Trajtimin e tokave bujqësore apo strategji që trajtojnë asetet në interes të Republikës së Kosovës;
 - Amandamentimin/ndryshimin sa i përket financimit të aktiviteteve të AKP-së për buxhetin e viteve 2020 e tutje. AKP-ja sipas nenit 21 të Ligjit aktual me nr. 04/L-034 nuk do të ketë mjete në dispozicion për mbulim të shpenzimeve për zhvillim e aktiviteteve operative dhe administrative për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të përcaktuar nga ky Ligj.
- **Gjykatat** - Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme dhe Gjykatat Themelore kanë kapacitete të limituara sa i përket shqyrtimit të lëndëve për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Varësisht nga kompleksiteti i rasteve, shqyrtimi dhe vendimi përfundimtar mund të merr shumë kohë (vite). Të gjitha proceset (administrimi, shitja dhe likuidimi) lidhen me Gjykatat. Janë mijëra raste gjyqësore që duhet trajtuar në instanca të ndryshme;
- **Komunat** – faktorë relevant në përshpejtimin e kohës dhe përgatitjes të aseteve për shitje. P.sh. vonesa në qasjen e dokumenteve kadastrale apo komuna në mënyrë të njëanshme, në emër të saj, ka ndërruar titullarin e pronësisë;
- **Komunat në pjesën veriore të Republikës së Kosovës** - ekziston një numër i konsiderueshëm i aseteve në këtë pjesë, për të cilat ka mungesë të bashkëpunimit me këto komuna, që mund të krijojnë vonesa në realizimin e shitjeve të aseteve;
- **ATK-ja** - Vonesa në dhënie të informacioneve për barrën tatimore dhe vonesa në heqjen e barrës tatimore. Gjithsesi është rritur bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve;
- **Qeveria** - Pagesa e pronave të shpronësuar nga ana e Qeverisë. Janë 912 asete të cilat janë shpronësuar dhe për të cilat duhet paguar mjetet nga ana e Qeverisë;

- **Qiratë nga Qeveria dhe institucionet relevante** - pronat e shfrytëzuara me qira të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare. P.sh. nga përvoja e AKP-së, ka dy vite që institucionet ende nuk kanë bërë ndonjë zgjidhje për zhvendosjen e zyrave të AKP-së. Janë 86 asete, të cilat shfrytëzohen (pa kontratë) nga Qeveria dhe institucionet ndërkombëtare;
- **Ndërtimet joligjore** - Janë përafërsisht të njohura 2,500 raste. Veçanërisht lidhen edhe me Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (shih më lartë);
- **Ofertat e blerësve** – Mund të ketë asete (ashtu siç ka pasur raste këtë vit) të cilat nuk janë atraktive për tërheqjen e investorëve/blerësve, faktor ky i cili ndikon në ri-tenderimin e aseteve për shitje për shkak të mungesës së ofertave;
- **Tjera** – mungesë e dokumentacionit në përcaktimit të statusit të NSH-ve dhe trajtimit të shitjeve të aseteve të tyre.

Të gjithë këta faktorë të shënuar më lartë, ndër vite kanë qenë dhe janë ende sfida dhe pengesa lidhur me procesin e privatizimit dhe likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore. Gjithsesi, këto sfida vit pas viti janë bërë më të lehta, kjo për shkak të ngritjes të kapaciteteve ndër institucionale, por ka shumë punë për të bërë në nivel qendror dhe lokal, sidomos në shqyrtimin e lëndëve nga Dhoma e Posaçme e Kosovës dhe bashkëpunimin e komunave, të cilat janë faktorë kyç në përshpejtimin e proceseve.

2. KORNIZA LIGJORE

1. Ligji i AKP-së nr. 04/L-034 të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115;
2. Akti themelues i AKP-së;
3. Statuti i Bordit të Drejtorëve të AKP-së;
4. Politikat Operacionale të AKP-së dhe Anekset e saj:
 - 4.1. Rregullat e Procedurës të Komisionit për shqyrtim të ankesave ndaj listave të punëtorëve.
5. Procedurat Financiare të AKP-së;
6. Udhëzuesi i Likuidimit me Anekset e tij:
 - 6.1. Lista me Format/Formularët për Likuidim;
 - 6.2. Udhëzuesi për Shqyrtimin e Kërkesave të Caktuara të Punës (marrëdhënia e punës);
 - 6.3. Udhëzuesi për Shqyrtimin e Kërkesave Pronësore (të NSH-së) gjatë periudhës së transformimit;
7. Rregullorja për kompensimin e anëtarëve të Bordit;
8. Udhëzuesi për procedurën e shpërndarjes së të hyrave nga 20%;
9. Udhëzuesi mbi procedurat e prokurimit për përdorim nga Ndërmarrjet Shoqërore (jo në likuidim);
10. Udhëzuesi mbi procedurat e prokurimit për përdorim nga Ndërmarrjet Shoqërore në likuidim;
11. Procedurat e brendshme të Sekretarisë Ekzekutive të Bordit të Drejtorëve;
12. Procedurat Bankare të AKP-së;
13. Rregullorja mbi Ruajtjen e Integritetit të AKP-së;
14. Rregullorja për përdorimin e vulave zyrtare të Agjencisë dhe Autorizimi për lejimin e përdorimit të vulave zyrtare të Agjencisë nga Autoriteti i Likuidimit;
15. Statuti Njësisë së Auditimit të Brendshëm (NJAB);
16. Rregullorja për përcaktimin e mënyrave të kompensimit për menaxherët si dhe punëtorët tjerë të NSH-ve nën mandatin e Njësisë së Administrimit Direkt;
17. Rregullorja për procedurën e rekrutimit të Drejtorit Menaxhues, dy Zëvendës Drejtorëve Menaxhues dhe Drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive të Bordit të Drejtorëve;
18. Rregullorja për zhvillimin e punonjësve dhe ngritje të kapaciteteve;
19. Rregullorja për procedurat dhe masat e nevojshme për sigurinë e personave që hyjnë dhe dalin në AKP;
20. Rregullorja e brendshme e Agjencisë për Vlerësim të Performancës së Menaxhmentit;
21. Politikat mbi pagesën e pjesshme për punëtorët e NSH-ve;
22. Rregullorja e Pagave për nëpunësit e Agjencisë;
23. Rregullorja e Personelit për nëpunësit e Agjencisë;
24. Rregullorja e Përdorimit të Veturave zyrtare të Agjencisë;
25. Rregullat e Procedurës për Shitjen e Banesave të NSH-ve;
26. Rregullorja për qiradhënien e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore;
27. Rregullat e Procedurës së Komisionit për shqyrtimin e listave fillestare të punëtorëve (KShLFP);

28. Vendimi për lirim të aseteve të uzurpuara të NSh-ve dhe Udhëzuesi për lirim të aseteve nga uzurpatorët;
29. Rregullorja për Procedurat e Njesisë së Kontrollit dhe Mbikëqyrjes gjatë Monitorimit të Ndërmarrjeve të Privatizuara me Spin Off Special dhe me Kushte;
30. Rregullorja mbi Procedurat e trajtimit të llogarive të arkëtueshme;
31. Udhëzuesi për Menaxhimin e Performancës së Personelit;
32. Udhëzuesi për Teknologjinë Informative;
33. Statuti i Komitetit të Auditimit;
34. Rregullorja e punës së Njesisë së Administrimit Direkt;
35. Rregullorja e Sekretarisë Ekzekutive të Bordit;
36. Rregullorja për qasje në dokumente zyrtare dhe klasifikim të informacionit;
37. Udhëzuesi për zyrtarët e rastit lidhur me pagesat e faturave për tatimin në pronë nga data e fillimit të likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore në likuidim;
38. Udhëzimi Administrativ për Inicimin dhe Pagesat nga Buxheti i AKP-së;
39. Rregullore për shqyrtimin e aseteve me karakter specifik dhe shitja e tyre me negociim të drejtpërdrejtë;
40. Rregullore për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Agjenci;
41. Udhëzuesi për Menaxhimin dhe Funkcionimin e Linjës së Posaçme Telefonike;
42. Plotësim ndryshimi i procedurave të shitjes dhe rregullave të tenderit;
43. Strategjia për media;
44. Amadamentimi i Rregullave të Tenderit;
45. Plotësim/ndryshimi i paragrafit 10.2.2. të nenit 10 të Rregullores për Zhvillimin e Punonjësve dhe Ngritje të Kapaciteteve;
46. Plotësim/ndryshimi i Rregullave të procedurës së punës së Komisionit për Shqyrtimin e Listave fillestare të Punëtorëve (KShLFP);
47. Plotësim/ndryshimi i Rregullores për Pagat e nëpunësve në Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

3. PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT

3.1. MISIONI DHE VIZIONI

3.1.1. MISIONI

Agjencia është e autorizuar për administrimin, duke përfshirë autorizimin për shitjen, transferimin dhe/ose likuidimin e ndërmarrjeve dhe aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Për realizimin e këtij misioni, Agjencia mban dhe administron secilën ndërmarrje dhe aset (nën mandatin e saj) në mirëbesim dhe në të mirë të pronarëve dhe kreditorëve të tyre, si dhe shet, transferon ose likuidon ndërmarrjet dhe asetet në përputhje me ligjin.

3.1.2. VIZIONI

Agjencia është e vendosur për të trajtuar me shpejtësi ndikimet pozitive për ekonominë si dhe nxitjen e investimeve në Ndërmarrjet Shoqërore, përmes autorizimeve të gjera publike administrative që i ka mbi këto ndërmarrje dhe asete, duke përfshirë, por pa u kufizuar, mandatin dhe autoritetin për shitjen ose bartjen e këtyre ndërmarrjeve dhe/ose aseteve tek investitorët privatë, ose likuidimin e tyre përmes një procesi të hapur, transparent, konkurrues dhe pa vonesa.

3.2. KOMPETENCAT E AGJENCISË SIPAS LIGJIT

Agjencia Kosovare e Privatizimit është organ i pavarur publik i cili i ushtron funksionet dhe përgjegjësitë në mënyrë plotësisht autonome. Agjencia ka zotësi të plotë juridike, posaçërisht për të bërë kontrata, për të marrë, mbajtur ose shitur pronën, si dhe ka të gjitha kompetencat e vetëkuptueshme për përmbushjen në tërësi të detyrave dhe kompetencave të dhëna me Ligjin nr. 04/L-034, si dhe të padisë e të paditet në emër të saj.

Agjencia Kosovare e Privatizimit është themeluar nga Kuvendi i Kosovës në Korrik të vitit 2008 si pasardhëse e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) që është themeluar dhe rregulluar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12 "Mbi Themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit", dhe të gjitha asetet dhe përgjegjësitë e saj do të jenë asete dhe përgjegjësi të Agjencisë.

Agjencia Kosovare e Privatizimit i raporton Kuvendit të Kosovës në baza vjetore.

Gjatë periudhës raportuese, aktivitetet e përgjithshme të Agjencisë janë menaxhuar nga Drejtori Menaxhues, Zëvendës Drejtori Menaxhues-Shitje dhe Zëvendës Drejtori Menaxhues-Likuidim.

Brenda Agjencisë Kosovare të Privatizimit janë edhe departamentet si në vijim:

- Departamenti i Shitjes;
- Departamenti i Likuidimit;
- Departamenti i Koordinimit Rajonal;
- Departamenti Ligjor;
- Departamenti i Marketingut, Marrëdhënieve me Publikun dhe Investitorët;
- Departamenti i Burimeve Njerëzore;
- Departamenti i Administratës;
- Departamenti i Financave dhe Buxhetit;
- Departamenti i Prokurimit; dhe
- Departamenti i Komisioneve Profesionale.

4. FUSHËVEPRIMI QË MBULON AGJENCIA

Ndërmarrjet Shoqërore kanë funksionuar në sektorë të ndryshëm duke përfshirë përpunimin e metalit, plastikës, letrës, hotelieri, miniera, agro-industri, bujqësi, pylltari, material ndërtimor, ndërtimtari, tekstil, verari dhe vreshtari, prodhimin e birrës, duhanit, shitjen me shumicë dhe pakicë.

NSh-të zënë rreth 90% të industrisë dhe minierave në Kosovës, 50% të hapësirës për shitje komerciale me pakicë dhe më pak se 20% të tokës bujqësore duke përfshirë tërë tokën komerciale bujqësore dhe shumicën e pjesës malore të Kosovës.

Shumica e pronës industriale e Kosovës, toka bujqësore, pyje, tokë urbane komerciale dhe pronë komerciale janë pronë e NSh-së. Privatizimi i këtyre aseteve dhe tërheqja e investitorëve të huaj si dhe atyre nga diaspora, rajoni dhe Kosova pritet që të kenë ndikim pozitiv në ekonominë dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

AKP-ja deri në datën raportuese ka menaxhuar me 583 Ndërmarrje Shoqërore. Ndërsa, në periudha të ndryshme janë larguar gjithsej 93 NSh nga mandati i AKP-së. Sipas Ligjit dhe me vendim të Bordit të Drejtorëve janë si më poshtë:

PËRSHKRIMI	NUMRI
Trepça (20 njësi biznesore)	20
Ekonomitë Pyjore	23
Kosovatransat	13
NSh-të që janë hequr me vendime të Bordit	37
GJITHSEJ:	93

4.1. BORDI I DREJTORËVE

Bordi i Drejtorëve është organi më i lartë i Agjencisë dhe ka kompetencë të plotë mbi Agjencinë. Bordi i Drejtorëve i AKP-së takohet në baza të rregullta mujore në mënyrë që t'i kryej funksionet dhe përgjegjësitë e tij sipas Ligjit. Bordi i Drejtorëve përbëhet nga tetë (8) anëtarë vendorë duke përfshirë një anëtarë të komunitetit jo-shumicë dhe një përfaqësues nga sindikatat e punëtorëve të cilët janë emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Mandati i Bordit të Drejtorëve është katër vjeçar për të gjithë anëtarët e Bordit. Gjashtë anëtarë të rinj të Bordit janë emëruar me 30 Maj 2018 nga Kuvendi i Kosovës, ndërsa Kryesuesi ka dhënë dorëheqje me 29 Tetor 2018 dhe Zëvendës Kryesuesit i ka skaduar mandati me 16 Dhjetor 2018. Si rrjedhojë e rrethanave të reja që do të krijoheshin pas skadimit të mandatit të Zëvendës Kryesuesit të Bordit, Bordi zgjodhi Zëvendës Kryesuesin e ri të Bordit të Drejtorëve të AKP me mandat prej 17 Dhjetorit 2018. Më 23 Nëntor 2018 Bordi i Drejtorëve e ka emëruar Drejtorin Menaxhues me mandat 4 vjeçar.

Gjatë vitit 2018, deri në fund të këtij viti, Bordi ka mbajtur 9 mbledhje, ku janë marrë gjithsej 135 vendime formale dhe shumë udhëzime për veprim për Menaxhmentin. Në vijim, në mënyrë përmbledhëse janë të paraqitura aktivitetet e Bordit për këtë periudhë:

- Janë aprovuar shitjet nga valë të shitjeve të aseteve në likuidim
- Janë shpallur valët të shitjes së aseteve (SHAL 39 - SHAL 43A) për shitje përmes tenderit publik;
- Janë bërë shpërndarjet e përkohshme për kreditorët e Ndërmarrjeve Shoqërore;
- Janë bërë shpërndarjet për ish-punëtorët e Ndërmarrjeve Shoqërore nga 20% i shitjeve;
- Janë aprovuar raporte të Komisionit për Shitjen e Banesave në Pronësi Shoqërore;
- Janë aprovuar raporte të Komisionit për Shqyrtimin e Aseteve me Karakter Specifik;
- Janë aprovuar raporte të Komisionit për Negociata Direkte;
- Janë aprovuar qiradhënie të aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore;
- Janë aprovuar dhe/ose amandamentuar akte nënligjore të Agjencisë, si:
- Amadamentimi i Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit - 25 Korrik 2018 (Informatë: me këtë rast janë shuar

pozitat e Kryesuesit të Njesisë së Protokollit dhe Kryesuesit të Njesisë së Transportit dhe asnjë ndryshim tjetër);

- Udhëzuesi për procedurat e parcelizimit të parcelave kadastrale në pronësi të Ndërmarrjeve Shoqërore - 25 Korrik 2018;
- Plotësim/ndryshimi i tabelës 6.2 të Rregullores për Pagat e nëpunësve të AKP-së - 30 Gusht 2018;
- Amadamentimi i Rregullores së Sekretarisë së Bordit - 30 Gusht 2018 (Informatë: me këtë rast është fshirë neni 7 dhe asnjë ndryshim tjetër);
- Amadamentim i nenit 4.11 të Rregullores së Personelit të Agjencisë - 24 Shtator 2018.
- Janë aprovuar raporte për përcaktimin e statusit të Ndërmarrjeve Shoqërore;
- Janë ndëshkuar financiarisht sipas marrëveshjes së zotimit për ndërmarrjet e privatizuara me kushte;
- Janë miratuar termat e referencës dhe buxhetit si dhe shpallja e tenderit publik për periudhën pesë vjeçare për angazhimin e OShP-së për projektin e likuidimit;
- Është aprovuar buxheti për vitin 2019 si dhe raporte tjera që u përcillen institucioneve qendrore sipas ligjit në fuqi;
- Me datë 10 Gusht 2018 është nënshkruar Memorandum Mirëkuptimi mes AKP-së, Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike - transferimin/shkëmbimin e të dhënave për ndërmarrjet e listuara nga Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe të dorëzuara të Qeveria si asete potenciale për t'u trajtuar përmes Ligjit nr. 05/L-079 për Investime Strategjike;
- Gjatë vitit 2018 gjithsej 86.3 milion euro janë transferuar në Buxhetin e Kosovës (42.4 milion fonde të mbetura dhe 43.9 milion fonde të përkohshme);
- Me 10 Shtator 2018 është bërë bartja/transferimi i PRN067 NSh "Qendra Shoqërore Sportive, Kulturore dhe Ekonomike" Pallati i Rinisë me seli në Prishtinë nga kompetencat e Agjencisë tek Komuna e Prishtinës - kjo përmes nënshkrimit të Marrëveshjes së pranidorëzimit mes AKP-së, Komunës së Prishtinës dhe Qeverisë së Kosovës;
- Bordi i Drejtorëve ka shkarkuar Drejtorin Menaxhues të AKP-së më 26 tetor 2018, ndërsa në mbledhjen e datës 23 Nëntor 2018 është emëruar Drejtori i ri Menaxhues;

- Janë miratuar Termat e Referencës për Zhvillimin Afarist të Goleshit, si projekt i financuar nga GIZ, në kuadër të rritjes së vlerës së NSh-së dhe tërheqjes së investimeve të huaja;
- Janë aprovuar transferimet e pronave në përputhje me Vendimin përfundimtar për Shpronësim për institucione apo komuna vetëm pas pagesës së mjeteve sipas nenit 6A të Ligjit të AKP-së.

5. DEPARTAMENTI I SHITJES

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2018 nuk kishte Bord të Drejtorëve të AKP-së gjë që ndikoi që mos të ketë shitje në pjesën e parë të vitit 2018 sepse të gjitha shitjet i aprovon Bordi i Drejtorëve të AKP-së.

Në pjesën e parë të vitit 2018 aktiviteti kryesor i Departamentit të Shitjes ishte përfundimi i kontratave dhe aktiviteteve tjera përcjellëse për shitjet që ishin zhvilluar në fund të vitit 2017. Gjithsej gjatë vitit 2018 u finalizuan dhe u dorëzuan të blerësit 120 kontrata të shitjes.

Me kompletimin e Bordit të Drejtorëve të AKP-së u bë azhurnimi i planit të shitjes dhe u vendos që deri në fund të vitit 2018 të mbahen gjithsej 05 shitje të aseteve.

Një ndër objektivat kryesore të AKP-së është rritja dhe ruajtja e vlerës të aseteve të NSh-ve dhe të AKP-jë përpiket të ruaj raportin e realizmit të shitjeve me vlerën e synuar. Pra strategjia është sfiduese e cila kërkon ruajtjen e këtij bilanci dhe e cila kryesisht varet nga faktorët e jashtëm dhe situatat e mëposhtëm:

- Fuqia blerëse – absorbimin e ofertave kundrejt vëllimit të shitjeve;
- Menaxhimin efikas dhe efektiv të aseteve – p.sh. afatet kohore të marrëveshjeve të qirave dhe vënja në dispozicion për shitje tek blerësit;
- Koordinim me institucionet relevante të tilla si: objektet e shfrytëzuara nga institucionet, ngritjen e kapaciteteve në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, komunat, bashkëpunimi me ATK-në rreth barrës tatimore etj.;
- Lirimin e aseteve nga uzurpatorët;
- Trajtimin e ndërtimeve ilegale të aseteve të NSh-ve; dhe
- Kompletimin e dokumentacionit (regjistrave kadastral).

Duke filluar nga gushti i vitit 2018, Bordi ka aprovuar shpalljen e pesë shitjeve të aseteve përmes likuidimit. Gjithsej deri në fund të vitit 2018 janë tenderuar 352 asete.

Duhet theksuar se dita e shitjes për shitjen e aseteve 43 është mbajtur në dhjetor 2018, por të gjitha procedurat tjera për këtë shitje zhvillohen në vitin 2019.

Shitja përmes Likuidimit	Nr. i Aseteve	Nr. i Ofertave të Pranuara	Gjithsej Vlera e Ofertave Fituese	Tërheqjet, Anulimet	Gjithsej Vlera	Nr. i Aseteve të anuluara nga BiD, tërheqjet	Kontra- tat e real- izuara	Shitjet e pareal- izuara - në proces
39	114	87	1,765,337	1,034,501	730,836	22	16	01
40	85	98	2,228,982	1,060,561	1,168,421	19	05	02
41	33	43	1,660,034	544,631	1,115,403	08	01	08
42	53	71	2,645,924	1,049,901	1,596,023	15	02	14
43	67	48	1,001,489	188,394	813,095	07	00	14
Gjithsej	352	347	9,301,766	3,877,988	5,423,778	71	24	39

*tabela e mësipërme paraqet rezultatet sipas prerjes së periudhës 31 dhjetor 2018. Këto rezultate mund të ndryshojnë në periudhat pasuese, pasi që mund të ketë tërheqje apo anulim të tenderit nga Bordi i Drejtorëve apo faktorë të tjerë që janë jashtë administrimit të AKP-së.

Duhet theksuar se në vitin 2018 ka filluar shitja e aseteve me negociim direkt për të cilat Departamenti i Shitjes e kryen inkasimin e mjeteve dhe përgatitjen e kontratave. Kontratat e para do të dorëzohen te blerësit në janar 2019.

6. NJËSIA E MONITORIMIT, KONTROLLËS DHE ADMINISTRIMIT DIREKT

6.1. SPIN OFF-ET SPECIALE

Njësia për Monitorim, kontroll dhe Administrim Direkt ka për detyrë që të monitorojë përmbushjen e zotimeve për investime kapitale, zotimit për punësim dhe vazhdim të aktivitetit të biznesit, sipas Marrëveshjes për Zotime për ndërmarrjet e privatizuarit përmes metodës së Spin Off-it Special dhe Spin Off-et me kushte.

Gjithashtu NJMKAD merret edhe me administrimin me ndërmarrjet të cilat kanë vështirësi financiare dhe

biznesore prandaj me qëllim të rritjes së kontrollit dhe efikasitetit të këto ndërmarrje Bordi i Drejtorëve i AKP-së ka vendosur për futjen e këtyre ndërmarrjeve në Administrim Direkt.

Përpos kësaj nga ndërmarrjet që janë ende aktive dhe nuk janë futur në likuidim, NJMKAD nga zyret regjionale pranon raportet financiare.

Ndërmarrja e Re “Agrokosova Holding” Suharekë

Agjencia Kosovare e Privatizimit më datën 23 prill 2018 ka angazhuar kompaninë audituese “Grand Thorton” për të bërë auditimin e përmbushjes së zotimeve për investime kapitale dhe punësim për periudhën nga 01.01.2015 deri 30.04.2015.

Kompania audituese ka bërë disa njoftime se po ka vështirësi në kryerjen e auditimit ngase disa informata që ata konsiderojnë se janë relevante për kryerjen e auditimit nuk po iu sigurohen nga ana e blerësve të ndërmarrjes së re prandaj më datën 13.09.2018 ka dorëzuar një letër përcjellëse në AKP sipas së cilës letër ata për shkak se nuk kanë pranuar një numër të caktuar të informatave nga ana e blerësve ata kanë kufizim në fushëveprim dhe se nuk janë në gjendje të kryejnë angazhimin e tyre dhe të lëshojnë raport të pavarur të sigurisë së kufizuar.

Pas kësaj më datën 1 tetor 2018 aksionari “QMI” sh.p.k nëpërmjet avokates së tyre ka bërë ankesë në raportin e auditimit dhe konsideron se ky raport nuk është i drejtë dhe si i tillë, shfrytëzuesit të këtij opinionit i bënë të marrim vendime të gabuara. Gjithashtu aksionari “QMI” sh.p.k propozon që për shkak se ata kanë bërë investime edhe pas periudhës së auditimit të bëhet një auditim i ri i cili do të përfshinte periudhën nga 01 janar 2015 deri më 30 shtator 2018.

Lidhur me këtë menaxhmenti i AKP-së ka dorëzuar memo për Bordin e Drejtorëve të AKP-së.

6.2. SPIN OFF-ET ME KUSHTE TË VEÇANTA

Ndërmarrja e Re “Emin Duraku Edico” Gjakovë

Ndërmarrja e Re “Emin Duraku Edico” shpk në Gjakovë është privatizuar me Spin Off me Kushte në Valën 45-A të shitjes. Ratifikimi i kontratës është bërë me 13 gusht 2012, ndërsa Marrëveshja e Zotimeve përfshinë periudhën nga 01.03.2013 deri 28 shkurt 2018. Gjatë periudhës monitoruese blerësi ka dorëzuar raportet në përputhje me marrëveshjen e zotimeve dhe ka mbajtur aktivitetin e tij bazuar në kontratën e shitjes. Pas përfundimit të marrëveshjes së zotimit, AKP ka angazhuar kompaninë audituese “Grant Thorton” e cila kompani konstaton se blerësi ka vazhduar dhe ruajtur aktivitetin e saj për periudhën 5 (pesë) vjeçare nga data 01 mars 2013 deri më 28 shkurt 2018. Bordi i Drejtorëve i AKP-së në mbledhjen e mbajtur më 25 qershor 2018 bazuar në nenin 6, pika 6.1 të marrëveshjes së zotimeve ka vendosur për lirim të ndërmarrjes nga marrëveshja e zotimeve.

Ndërmarrje e Re “Famipa” Prizren

Ndërmarrja e Re “Famipa” sh.p.k. është privatizuar në valën 49 të shitjes, ndërsa Kontrata e Shitblerjes

është nënshkruar me datën 13 Shtator 2011. Shtojca 5, Seksioni B i Deklaratës së bartjes të aseteve dhe detyrimeve parasheh që blerësi i Ndërmarrjes së Re “Famipa” do të vazhdojë aktivitetin e njëjtë në ndërmarrje (prodhimin dhe përpunimin e metaleve) si dhe nuk do të çmontojë dhe dislokojë pajisjet nga ndërmarrja deri në përfundim të kontratës.

Bordi i Drejtorëve i AKP-së në mbledhjen e mbajtur më 25 qershor 2018 për shkak të mos mbajtjes së aktivitetit nga ana e blerësit në përputhje me marrëveshjen e zotimit ka aplikuar ndëshkimet financiare në vlerë prej 30 % të çmimit të shitjes.

Ndërmarrja e Re “Fabrika e Baterive Industriale Trepça” Pejë

Ndërmarrja e Re “Fabrika e Baterive Industriale Trepça” sh.p.k. është privatizuar si projekt individual ndërsa kontrata e shitjes është ratifikuar me datën 14 qershor 2013 dhe periudha e zotimeve ka qenë deri më 14 qershor 2016. Agjencia Kosovare e Privatizimit ende nuk ka shqyrtuar raportin për përmbushjen e zotimeve nga ana e blerësit për shkak të mos qartësisë të një parcele kadastrale ku AKP edhe përkundër marrjes së një numri të madh veprimesh nuk ka arritur të konstatojë qartë se parcela në fjalë ka qenë si aset i përfshirë në privatizim me rastin e shitjes së Ndërmarrjes së Re. Gjithashtu menaxhmenti i AKP-së ka dërguar shkresë dhe ka kërkuar nga organet kompetente që të shqyrtojnë dhe hetojnë këtë situatë lidhur me këtë parcelë kadastrale.

Ndërmarrja e Re “Sharr Cem” Hani i Elezit

Pas përfundimit të auditimit të përmbushjes së zotimeve për investime kapitale dhe punësim, AKP bazuar në vendimin e Bordit të Drejtorëve të AKP-së ka angazhuar kompaninë audituese “BDO Kosova” për të bërë auditimin e ndikimit të kushteve të tregut bazuar në kontratën e shitblerjes të datës 09.10.2010.

Kompania audituese ka bërë auditimin bazuar në termat e referencës dhe sipas raportit të auditimit kushtet e tregut nuk kanë pasur ndikim material në mos përmbushjen e zotimeve për investime kapitale. Prandaj bazuar në këtë Bordi i Drejtorëve i AKP-së në mbledhjen e mbajtur më 23 nëntor 2018 ka marrë vendim që bazuar në nenin 7 paragrafi 7.1 i marrëveshjes së shitblerjes për diferencën e mos përmbushjes së zotimeve për investime kapitale, blerësi këtë diferencë ta paguaj si çmim shtesë për blerjen e aksioneve.

Ndërmarrja e Re a “Kualiteti International” Gjilan

Gjatë vitit 2018 nuk është zhvilluar ndonjë aktivitet në këtë ndërmarrje por është duke u pritur vendimi i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme në ankesën e AKP-së ndaj vendimit të shkallës së parë.

6.3. ADMINISTRIMI DIREKT

Ndërmarrja e Re “MIM Golesh” Magure

Ndërmarrja e Re “MIM Golesh” aktualisht nuk është duke inkasuar të hyra nga aktiviteti i saj primar apo shitja e materialeve të cilat janë të deponuara si stok por të gjithë të punësuarit i paguan nga mjetet financiare që ka në dispozicion e të cilat kanë mbetur nga kontrata me “Bechtel Enka”.

Në muajin dhjetor 2018 në Ndërmarrjen e Re “MIM Golesh” kanë qenë të angazhuar 43 punëtor dhe pagat neto të paguara për këta punëtor kanë qenë në vlerë prej 16,413.52 Euro.

Numri më i madh i punëtorëve është i angazhuar në ruajtjen e aseteve duke konsideruar faktin se hapësira e Ndërmarrjes është shumë e madhe 267 ha, ndërsa punëtorët tjerë janë të angazhuar në menaxhim dhe mirëmbajtje të aseteve të cilat janë shumë të rëndësishme për Ndërmarrjen, si dhe në administratë, kontabilitet etj.

Bordi i Drejtorëve të AKP-së në mbledhjen e mbajtur me 23 nëntor 2018, ka miratuar Termat e Referencës për projektin “Zhvillimi Afarist i Minierës së Goleshit”, si projekt i financuar nga GIZ, qëllimi i të cilit është që të zhvillohet plani afarist për Goleshin, si aset me potencial të konsiderueshëm për tërheqje të investimeve, krijim të vendeve të punës, dhe krijim të hyrave. Ky projekt është rezultat i bashkëpunimit të Agjencisë me institucionet Gjermane, dhe vazhde e projektit paraparak “Studimi i Parafizibilitetit për materiet minerare në Kosovë”.

NSH “Boksitet e Kosovës” Klinë

Gjendja në ndërmarrje është mjaftë e vështirë dhe të hyrat e vetme të cilat i realizon Ndërmarrja janë dhënia e aseteve me qira. Aktualisht Ndërmarrja ka tri asete të dhëna me qira – Zyra në Klinë, parkingun po ashtu në Klinë dhe Fabrikën e Llaçit në Volljak. Ka edhe një aset – Seperacioni në Volljak i cili më parë ka qenë i lëshuar me qira por për shkak të mos përmbushjes së obligimeve kontraktuese nga ana e qiramarrësit është shkëputur kontrata e qirasë. Për seperacionin është bërë shpallja publike për dhënie me qira por nuk ka pasur asnjë ofertë për atë aset.

Të hyrat mujore nga dhënia e aseteve me qira janë në vlerë prej 3,828.00 Euro, kurse në ndërmarrje janë të punësuar 17 punëtor prej të cilëve 2 paguhen nga subvencionet, 3 janë ofrues të shërbimeve dhe 12 janë punëtor të cilët paguhen nga të hyrat e ndërmarrjes.

NSH “Ereniku Industria” Gjakovë

Të hyrat e vetme të cilat i realizon Ndërmarrja janë dhënia e aseteve me qira. Aktualisht Ndërmarrja ka tri asete të dhëna me qira. Të hyrat mujore nga dhënia e aseteve me qira janë në vlerë prej 1,368.00 euro. Në ndërmarrje janë të punësuar 5 punëtor prej të cilëve dy paguhen prej subvencioneve dhe tre nga të ardhurat e ndërmarrjes. Gjithashtu në ndërmarrje janë të angazhuar edhe 6 punëtor si ofrues të shërbimeve të cilët merren me ruajtjen e aseteve të ndërmarrjes.

NSH “Virxhinia” Gjakovë

Bordi i Drejtorëve i AKP-së në mbledhjen e mbajtur më 21 dhe 25 shtator 2017 ka vendosur për futjen e kësaj ndërmarrje në Administrim Direkt. Ndërmarrja nuk e zhvillon aktivitetin e saj primar por të hyrat e vetme të cilat i realizon Ndërmarrja janë dhënia e aseteve me qira. Aktualisht Ndërmarrja ka tetëmbëdhjete (18) kontrata të qirasë dhe të hyrat mujore janë afër 3,000.00 Euro. Në ndërmarrje janë të punësuar 22 punëtorë prej të cilëve tre janë në Bordin e Përkohshëm Menaxhues të Ndërmarrjes. Pagat neto mujore të cilat paguhen nga ndërmarrja janë rreth 2,000.00 Euro.

NSH “Jatex” Gjakovë

Bordi i Drejtorëve i AKP-së në mbledhjen e mbajtur më 21 dhe 25 shtator 2017 ka vendosur për futjen e kësaj ndërmarrje në Administrim Direkt. Edhe kjo ndërmarrje nuk realizon të hyra nga aktiviteti primar por të hyrat kryesisht i ka nga dhënia e objekteve me qira në Kosovë dhe jashtë saj. Janë të dhëna me qira 32 lokale dhe vlera mujore e inkasimit të hyrave nga qiraja sillet rreth 13,000.00 Euro. Nga këto të hyra paguhen 53 punëtor të ndërmarrjes dhe vlera mujore e pagave bruto sillet rreth 9,100.00 Euro.

NSH “Metaliku” Gjakovë

Bordi i Drejtorëve i AKP-së në mbledhjen e mbajtur më 21 dhe 25 shtator 2017 ka vendosur për futjen e kësaj ndërmarrje në Administrim Direkt.

Gjendja në këtë ndërmarrje është mjaftë e vështirë dhe pjesa dërmuese e aseteve janë të dëmtuara dhe kryesisht kemi objektet të cilat janë pa makineri dhe jo funksionale. Pasi që deri në futjen e ndërmarrjes në

Administrim Direkt, Ndërmarrja nuk ka pasur asnjë të hyrë të realizuar nga qiraja apo ndonjë aktivitet tjetër, AKP me kërkesë të Bordit të Përkohshëm Menaxhues dhe me qëllim të rritjes së të hyrave të ndërmarrjes gjatë vitit 2018 ka lëshuar 6 objekte me qira ku vlera e qirasë mujore sillet rreth 1,217.00 kurse janë të angazhuar 7 punëtor prej të cilëve tre janë në Bord të përkohshëm menaxhues dhe 4 në ruajtjen e objekteve të ndërmarrjes.

NSH “Fabrika e Enëve” Gjakovë

Bordi i Drejtorëve i AKP-së në mbledhjen e mbajtur më 21 dhe 25 shtator ka vendosur për futjen e kësaj ndërmarrje në Administrim Direkt.

Ndërmarrja deri në futjen në Administrim Direkt nuk ka realizuar asnjë të hyrë dhe nuk ka pasur asnjë të punësuar. Pas futjes së ndërmarrjes në Administrim Direkt së bashku me Bordin e Përkohshëm Menaxhues janë identifikuar asetet që mund të ipen me qira dhe është bërë shpallja publike ku deri më tani vetëm dy asete janë dhënë me qira dhe qiraja mujore për këto asete është 250.00 Euro.

Në ndërmarrje momentalisht janë të punësuar 7 veta ku tre janë të angazhuar si roje dhe 4 janë në Bordin e Përkohshëm Menaxhues të Ndërmarrjes.

NSH “Iliria” Peje

Bordi i Drejtorëve i Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 30/31 mars 2017 ka marrë Vendim për vendosjen e NSH “Iliria” në Administrim Direkt të AKP-së. Gjatë vitit 2018 kemi pranuar vendimin nga Gjykata Supreme e Kosovës sipas së cilit vendim i njihet e drejta e pronës një Blerësi të saj i cili ka bërë blerjen e ndërmarrjes gjatë viteve të 90-ta. Agjencia Kosovare e Privatizimit ka bërë ankesë në këtë vendim dhe jemi duke pritur vendimin nga Gjykata në ankesë të saj. Ndërmarrja aktualisht nuk inkason asnjë të hyrë nga qiraja dhe nuk mund të shfrytëzon objektet e saj deri në ndonjë vendim tjetër nga ana e Gjykatës Supreme.

6.4. NDËSHKIMET FINANCIARE

Gjatë vitit 2017 janë aplikuar ndëshkimet financiare në vlerë prej 29,500.00 Euro për ndërmarrjen e re “IDGJ Tobacco” por gjithashtu me vendim të Bordit të Drejtorëve është vendosë që të shlyhen ndëshkimet e mëhershme për këtë ndërmarrje bazuar në kontratën e novacionit.

Më poshtë paraqesim tabelën e ndëshkimeve financiare. 6.5. ÇMIM I BLERJES SË AKSIONEVE

Ndërmarrje Re	Vlera e ndëshkimeve 01.01.2018	Vlera e ndëshkimeve 31.12.2018
Ndërmarrja e Re “Grand Hotel”	8,822,314.97	8,822,314.97
Ndërmarrja e Re “IDGJ Tobacco”	29,500.00	0.00
Ndërmarrja e Re “Xim Strezovc”	7,298,170.76	7,298,170.76
Ndërmarrja e Re “MIM Golesh”	8,447,812.27	8,447,812.27
Ndërmarrja e Re “Agrokosova Holding”	3,579,997.53	3,579,997.53
Ndërmarrja e Re “Llamkos”	1,715,488.79	1,715,488.79
Ndërmarrja e Re “Famipa”	0.00	1,170,000.00
Totali i ndëshkimeve financiare	29,834,284.32	31,033,784.32

Gjithashtu janë pjesë e pasqyrave financiare të fondeve në mirëbesim tek llogaritë e arkëtueshme “ndëshkimet financiare”.

Bordi i Drejtorëve ka vendosur që për ndërmarrjet “AgroKosova Holding” dhe “Llamkos Galvasteel” të pritët vendimet gjyqësore dhe pastaj të ndërmerren hapat e mëtutjeshëm, kurse për ndërmarrjet që iu janë marrë aksionet “Grand Hotel” Prishtinë; “MIM” Golesh dhe “XIM” Strezoc të ndërmerren hapat për inkasimin e tyre.

Gjatë vitit 2018 janë aplikuar ndëshkimet financiare për Ndërmarrjen e Re “Famipa” Prizren në vlerë prej 1,170,000.00 Euro për shkak të mos përmbushjes së kushteve të kontratës. Blerësi ka bërë ankesë në Dhomën e Posaçme për aplikimin e këtij ndëshkimi.

6.5. ÇMIMI I BLERJES SË AKSIONEVE PËR PËR MOSPËRMBUSHJE TË INVESTIMEVE

Për Ndërmarrjen e Re “Sharrcem” Hani i Elezit, vlera e mos përmbushjes së zotimeve për investime kapitale prej 9,441,768.83 bazuar në raportin e auditorit të pavarur është llogaritur si çmim i blerjes bazuar në kontratën e shit blerjes.

Ndërmarrja	Vlera 31.12.2018
Ndërmarrja e Re “Sharrcem” Hani i Elezit	9,441,768.83

Gjithashtu janë pjesë e pasqyrave financiare të fondeve në mirëbesim tek llogaritë e arkëtueshme “shitja e aseteve”.

7. DEPARTAMENTI I LIKUIDIMIT

7.1. LIKUIDIMI I NDËRMARRJEVE SHOQËRORE

Gjatë vitit 2018 kanë filluar procedurat e likuidimit dhe janë emëruar Autoritetet e Likuidimit për 12 Ndërmarrje Shoqërore gjegjësisht asete. Sipas procedurave të parapara me Ligj janë bërë publikimet e njoftimeve për kreditorët dhe pronarët e ndërmarrjeve në dy gazeta në Kosovë, një në Serbi

dhe një në Mal të Zi. Brenda afatit të paraparë ligjor për parashtrimin e kërkesave për këto ndërmarrje janë pranuar 206 kërkesa kreditore në Zyrat Rajonale përkatëse të AKP-së.

Lista e Ndërmarrjeve Shoqërore/Aseteve për të cilat kanë filluar procedurat e likuidimit gjatë vitit 2018

Nr.	Nr. ID AKP-së	Emri i Ndërmarrjes Shoqërore	Regjioni	Data e fillimit të likuidimit dhe emërimit të AL-së
1	MIT143	Njësia Punuese e Ndërmarrjes Industria-“Obuça” - Beograd	Mitrovicë	11 janar 2018
2	MIT154	Njësia Punuese e Ndërmarrjes “Cineoptic” - Novi Sad	Mitrovicë	11 janar 2018
3	PRN181	NSh Botuese "Rilindja"	Prishtinë	11 janar 2018
4	PRN182	NSh “Zëri i Rinisë”	Prishtinë	11 janar 2018
5	PRZ077	Kooperativa Banesore “Marash”	Prizren	11 janar 2018
6	PRZ089	KB “Vllashki Drenovc” - Drenovc	Prizren	11 janar 2018
7	PEJ200	KB “Kooperativisti” - Osojan	Pejë	11 janar 2018
8	GJI111	Ndërmarrja për prodhimin dhe qarkullimin e prodhimeve nga druri "Sar-Drvoexport"	Prizren	11 janar 2018
9	PRZ085	KB “Lubizhdë” - Lubizhdë	Prizren	12 shkurt 2018
10	PRZ082	KB “Banja” - Banjë	Prizren	12 shkurt 2018
11	PRN178	Asetet e Ndërmarrjes “Prvi Maj” - Pirot	Prishtinë	12 shkurt 2018
12	PRN134	Asetet e Ndërmarrjes “Invest Banka” - Beograd	Prishtinë	12 shkurt 2018

Në total, nga fillimi i tërë procesit deri në datën e raportimit janë gjithsej 512 Ndërmarrje Shoqërore për të cilat kanë filluar procedurat e likuidimit. Këto Ndërmarrje Shoqërore në likuidim janë administruar nga Autoritetet e Likuidimit (OSH-P me AKP-në) për NSH-të të cilat kanë asete sipas shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 - Ofruesin e Shërbimeve Profesionale.

Në muajin qershor 2018, bazuar në vendimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës të muajit mars 2018, Bordi i Drejtorëve të AKP-së ka vendosur që të largohet nga autoriteti administrativ dhe kompetencat e agjencisë NSH Qendra Shoqërore, Sportive, Kulturore dhe Ekonomike "Pallati i Rinisë" dhe t'i transferohet Komunës së Prishtinës, që rrjedhimisht e ka zvogëluar numrin e NSH-ve që janë në likuidim për një NSH. Marrëveshja tri-palëshe e pranimit-dorëzimit mes AKP-së, Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Komunës së Prishtinës është nënshkruar në muajin shtator 2018.

Me datën 7 gusht 2018 ka përfunduar aneksi 2 i kontratës me OSH-P-në, me ç'rast kanë dhënë dorëheqje të gjithë kryesuesit dhe anëtarët e AL-ve të emëruar nga OSH-P-ja; për 5 NSH aktive në regjionin e Prishtinës janë emëruar Autoritetet e Likuidimit konform nenit 13 të Shtojcës së Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit; gjatë muajit nëntor janë emëruar edhe 308 NSH të tjera gjithashtu sipas nenit 13 të ndryshuar dhe të plotësuar të Ligjit të AKP-së Nr. 06/L-023 për ato NSH të cilat kanë ende asete të pashitura.

PËRSHKRIMI	JANAR-DHJETOR	TËRË PROCESI (deri më 31 dhjetor 2018)
Numri i NSH-ve në likuidim	12	511
Numri i kërkesave të parashtruara nga kreditorët	206	91,031
Numri i kërkesave të shqyrtuara	233	90,778
Numri i NSH-ve të mbyllura sipas aktvendimeve të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) - (NSH-të pa asete dhe/ose pa kërkesa kreditore)	0	17
Numri i raporteve të shpërndarjes së parakohshme	15	176
Shuma e fondeve të aprovuara nga Bordi i Agjencisë për shpërndarje tek kreditorët e ligjshëm	€ 2,337,536.49	€ 26,620,651.42

Nga numri prej 91,031 të kërkesave kreditore, deri në datën e raportimit për 90,778 janë lëshuar vendimet për parashtruesit e kërkesave kreditore nga Autoritetet e Likuidimit. Gjatë vitit 2018 janë pranuar 206 kërkesa kreditore, ndërsa janë lëshuar 233 vendime për kërkesat e parashtruara nga kreditorët.

7.2. OFRUESI I SHËRBIMEVE PROFESIONALE

Ashtu siç është përshkruar më lartë, Ofruesi i Shërbimeve Profesionale ka qenë i angazhuar si pjesë e Autoriteteve të Likuidimit për Ndërmarrjet Shoqërore të cilat kanë asete dhe kërkesa kreditore. Kjo në përputhje me nenin 13 të shtojcës të Ligjit nr. 04/L-034 mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Aneksi 2 i kontratës ka përfunduar me 7 gusht 2018, me ç'rast janë kryer të gjitha obligimet ndaj tyre dhe është bërë raporti i harmonizimit të pagesave.

	A	B	C	C=A-B	D=B/A
PËRSHKRIMI	VLERA E KON- TRAKTUAR	PAGESAT E RE- ALIZUARA PËR GJATË ANEKSIT 2 TË KONTRATËS	PAGESAT E REAL- IZUARA	Shuma e mbetur nga aneksi 2 i kon- tratës	%
10% E VLERËS SË ANEKSIT 2 TË KONTRATËS	€1,992,000	1,992,000	581,000	0	100%

7.3. SHPËRNDARJA E MJETEVE NDAJ KREDITORËVE

Autoritetet e Likuidimit të NSH-ve në Likuidim kanë përgatitur raportet përfundimtare të shpërndarjes dhe ka vazhduar shpërndarja e mjeteve tek kreditorët e ligjshëm sipas raporteve të aprovuara nga Bordi i Agjencisë.

Në mbledhjet e mbajtura gjatë periudhës janar - dhjetor 2018, janë aprovuar për shpërndarje gjithsej 15 Ndërmarrje. Vlera e fondeve për shpërndarje sipas raporteve të aprovuara për 15 NSH është gjithsej EUR **2,339,526**. Në total shpërndarje janë bërë për 176 NSH, ndërsa vlera e shpërndarë për të gjitha këto NSH në total arrin vlerën prej **EUR 26,620,651**.

LLOJET E KREDITORËVE	SHUMAT E APROVUARA				PAGESAT 2011 - 2018	PAPAGUAR
	DERI MË 31 DHJETOR 2017	JANAR – DHJETOR 2018	GJITHSEJ			
Për paga të punëtorëve	10,774,217	718,585	11,492,800		11,394,271	98,529
ATK-ja	4,842,031	897,457	5,739,488		5,739,374	114
Trustet pensionale	2,292,645	189,513	2,482,159		2,477,719	4,440
Tatimi në pronë	1,288,141	42,519	1,330,660		1,330,068	592
Shërbimet publike	907,977	273,934	1,181,911		1,174,241	7,670
Kreditor të tjerë	4,176,112	217,518	4,393,630		4,338,338	55,292
GJITHSEJ	24,281,125	2,339,526	26,620,651		26,454,011	166,637

7.4. LIKUIDIMI I NDËRMARRJEVE SHOQËRORE PA ASETË DHE/OSE PA KËRKESA KREDITORE

Njësia e Likuidimit e cila bënë likuidimin e Ndërmarrjeve Shoqërore të cilat nuk kanë asete dhe/ose kërkesa kreditore.

Nga 39 Ndërmarrje Shoqërore janë likuiduar 16 prej tyre (tërë procesi) me vendim të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, ndërsa gjatë periudhës raportuese janë dërguar në DhPGjSK 3 Raporte Përfundimtare për aprovim të mbylljes së procesit të likuidimit të NSH-ve në fjalë.

1. Lista e Ndërmarrjeve të Likuiduara gjatë periudhës janar - dhjetor 2018

Nr.	Komuna	Emri i NSh-së	Kategoria	Data e fillimit të procesit të likuidimit	Data e prezantimit të Raportit Përfundimtar në Bordin e AKP-së	Data e prezantimit të Raportit Përfundimtar në DhPGJSK
1	Gjilan	KB Kishnapola	Pa asete / Me kërkesa kreditore	24 Shkurt 2014	25 Korrik 2018	2 Gusht 2018
2	Prizren	KB Vllashki Drenovc	Pa asete / Pa Kërkesa kreditore	11 Janar 2018	25 Korrik 2018	2 Gusht 2018
3	Gjilan	NSh Partizan Babush	Me asete / Pa kërkesa kreditore	9 Shator 2013	22 Nëntor 2018	4 Dhjetor 2018

2. Lista e Ndërmarrjeve të likuiduara gjatë tërë procesit

Nr.	Komuna	Emri i NSh-së	Kategoria	Data e fillimit të procesit të likuidimit	Data e prezantimit të Raportit Përfundimtar në Bordin e AKP-së	Data e prezantimit të Raportit Përfundimtar në DhPGJSK	Aktivendimi i DhPGJSK për mbylljen e likuidimit
1	Skenderaj	Kooperativa Bujqësore "Likovci"	Me asete / Pa kërkesa kreditore	05 gusht 2010	20 korrik 2012	16 gusht 2012	11 janar 2013
2	Skenderaj	Kooperativa Bujqësore "Liria"	Pa asete / Pa Kërkesa kreditore	04 gusht 2010	20 korrik 2012	16 gusht 2012	31 janar 2013
3	Skenderaj	NSh "Graniti"	Pa asete / Pa Kërkesa kreditore	09 gusht 2010	20 korrik 2012	16 gusht 2012	10 dhjetor 2012
4	Vushtrri	NSh SHAM "Ruzhdi Bytyqi"	Pa asete / Me kërkesa kreditore	19 qershor 2013	31 janar 2014	04 shkurt 2014	19 mars 2014
5	Mitrovicë	NSh "Hidrotermika"	Pa asete / Pa Kërkesa kreditore	31 dhjetor 2010	20 korrik 2012	16 gusht 2012	15 tetor 2012
6	Suharekë	NSh "SH.A.M. Semafor" Suharekë	Pa asete / Me kërkesa kreditore	31 dhjetor 2010	27 qershor 2013	28 qershor 2013	17 janar 2014
7	Pejë	Kooperativa Bujqësore "Ozdrim"	Pa asete / Pa Kërkesa kreditore	27 qershor 2013	19 dhjetor 2013	26 dhjetor 2013	27 shkurt 2014
8	Pejë	Kooperativa Bujqësore "Vitimirica"	Pa asete / Pa Kërkesa kreditore	27 qershor 2013	16 maj 2016	18 korrik 2016	1 gusht 2016
9	Prizren	NSh Shoqata "Auto Moto"	Pa asete / Me kërkesa kreditore	11 qershor 2013	16 maj 2016	18 korrik 2016	2 gusht 2016

10	Ferizaj	Kooperativa Bujqësore "Bibaj"	Pa asete / Pa Kërkesa kreditore	3 mars 2014	16 maj 2016	18 korrik 2016	24 gusht 2016
11	Ferizaj	Kooperativa Bujqësore "Xhafa"	Pa asete / Pa Kërkesa kreditore	23 qershor 2014	31 gusht 2016	21 shtator 2016	30 shtator 2016
12	Viti	Kooperativa Bujqësore "Visoqa"	Pa asete / Pa Kërkesa kreditore	3 mars 2014	21 shtator 2016	23 shtator 2016	14 tetor 2016
13	Ferizaj	Kooperativa Bujqësore "Gaçkë"	Pa asete / Pa Kërkesa kreditore	10 mars 2014	23 nëntor 2016	25 janar 2017	5 prill 2017
14	Ferizaj	Kooperativa Bujqësore "Agrokultura"	Pa asete / Pa kërkesa kreditore	10 mars 2014	30 mars 2017	11 prill 2017	21 qershor 2017
15	Han i Elezit	Ndërmarrja Shoqërore "16 Nëntori"	Pa asete / Me kërkesa kreditore	10 mars 2014	27 prill 2017	2 maj 2017	21 qershor 2017
16	Prizren	Ndërmarrja Shoqërore "Ndërtimi"	Pa asete / Me kërkesa kreditore	9 dhjetor 2013	25 maj 2017	6 qershor 2017	31 korrik 2017

7.5. NJËSIA PËR TRANZICIONIN E TREPÇËS

AKP gjatë gjithë vitit 2018 ka qenë në pritje të miratimit të statusit të Trepçës në Kuvend, status ky i cili duhet të propozohet nga Bordi Mbikëqyrës i Trepçës bazuar në Ligjin nr. 05/L-120. Kjo, pasi që statusi definon saktësisht njësitë e Trepça ShA, dhe kështu konstatohen njësitë të cilat mbesin jashtë ShA, dhe rrjedhimisht mbesin nën menaxhim të AKP, ndaj të cilave më pas mund të iniciohen veprime për likuidim dhe privatizim.

Për këtë arsye, AKP ka mirëpritur konstituimin e Bordit Mbikëqyrës të Trepça ShA në prill të vitit 2018. Mirëpo, edhe gjatë vitit 2018 statusi i Trepça ShA nuk është miratuar. Andaj, në mungesë të statusit dhe regjistrimit të Trepça ShA, AKP nuk ka mundur të inicioj veprime për likuidim dhe privatizim.

Në vitin 2018 NjTT ka përfunduar dhe kompletuar databazën me dokumentacion të Trepçës që ka poseduar AKP (elektronik dhe dokumente të vjetra hard copy). Këto të dhëna janë dorëzuar në Bord të Trepça ShA. Në vitin 2018, Raporti i Studimit të Fizibilitetit është dorëzuar në Kabinetin e Presidentit të Kosovës.

Pas kërkesave të pranura nga Komisionet Qeveritare të formuara enkas për çështje të Trepçës të cilat kanë kërkuar ndihmën e NjTT, AKP ka bashkëpunuar duke ndihmuar përmes NjTT-së këto komisione/grupe punuese duke kontribuar për tu plotësuar kushtet

për hartimin dhe miratim të statusit të shumëpritur.

n veprimet konkrete që duhet ndërmarrë, dhe, ku do të përcaktohet lartësia e investimeve të nevojshme për transformim të suksesshëm të Goleshit në qendër procesimi të metaleve industriale. Ky Biznes Plan, duhet të shërbej si udhërrëfyes në vendimmarrjen lidhur me MIM Goleshin në të ardhmen.

- Gjatë vitit 2018 NjTT ka marrë pjesë në takimet e grupit punues teknik për vlerësim të aseteve të "Trepça" ShA, i cili grup punues ka kërkuar ndihmën e AKP për realizim të detyrës së dhënë nga Qeveria. Këtij grupi NjTT i ka dorëzuar të gjitha të dhënat, informatat dhe këshillat e kërkuara.
- Gjithashtu gjatë vitit 2018, NjTT ka marrë pjesë në takimet e grupit punues për caktimin dhe shpërndarjen e 20% të aksioneve të punëtorëve të Trepça ShA.
- Gjatë vitit 2018, NjTT së bashku me Kryesuesin dhe Zëvendës Kryesuesin e Bordit të Drejtorëve të AKP-së, dhe Drejtorin Menaxhues kanë mbajtur takime me Bordin, Menaxhmentin dhe Sindikatat e Trepça ShA, në frymën e konsultimit për asistim në tejkalim të vështirësive të periudhës tranzitore të Trepça ShA.

Gjatë vitit 2018, punët si: plotësimi i dokumentacionit të njësive në listën e ndërmarrjeve të Trepçës të cilat priten të shkojnë në likuidim, koordinimi me zyrtarë të Departamentit Ligjor për procese të ndërlidhura me Trepçë, etj., kanë qenë punët të përditshme rutinore me të cilat është marrë NjTT.

Përveçpunëvetë lartcekura, si rezultat i bashkëpunimit dhe besimit të ndërsjellë me institucionet Gjermane dhe inicimit dhe hartimit të propozim projektit nga NjTT, në nëntor të vitit 2018 është miratuar financimi i projektit “Zhvillimi Komercial i Minierës së Goleshit”, i cili projekt do të financohet nga Ministria Gjermane

e Financave dhe do të realizohet përmes GIZ, në bashkëpunim me AKP dhe MIM Goleshin. Projekti pritet të fillojë të implementohet në shkurt të vitit 2019.

Në koordinim me GIZ dhe Ministrinë Gjermane të Financave, në shtator 2018, NjTT ka iniciuar, koordinuar dhe organizuar vizitën e Drejtorëve të Bordit dhe Drejtorit Menaxhues të AKP, në Agjencinë Gjermane të Mirëbesimit, në Ministrinë e Financave dhe ndërmarrjet e privatizuara, për të përfituar nga përvojat, por edhe mësuar nga gabimet që janë bërë gjatë procesit të privatizimit në RFGj.

8. DEPARTAMENTI I KOORDINIMIT RAJONAL

8.1. SHITJA DHE ADMINISTRIMI I ASETEVE

Zyrat Rajonale kanë përgatitur për shitje te aseteve në Likuidim me që rast janë përfshirë **440 asete** për shitje gjatë këtij viti të shpërndara në **6 Valë** të shitjes përmes Likuidimit, e që është numri më i lartë i aseteve të ofruara gjatë një viti për ekzistencës së AKP-së.

Zyrat Rajonale kanë përgatitur për shitje përmes Likuidimit numrin e aseteve siç është paraqitur në tabelën më poshtë:

SHAL	Nr. i Aseteve	Asete të tërhequra	Data e prezantimit të Raportit Përfundimtar në DhPGJSK
SHAL39	133	19	114
SHAL40	97	12	85
SHAL41	44	11	33
SHAL42	62	9	53
SHAL43	71	4	67
SHAL43A	33	0	33 asete (data e ofertimit më 23.01.2019)
Total	440	55	385

Gjatë këtij viti janë përgatitur dhe përfunduar 33 asetet e përfshira për SHAL43A shpallje kjo në dhjetor të 2018 të cilat i përfshin të gjitha asetet që janë ritenderuar më shumë se tri herë. Po ashtu gjatë këtij viti janë përgatitur të gjitha dokumentet fillestare dhe draft dokumentet përfundimtare për shqyrtim nga njësia përkatëse për 95 asetet të aprovuara nga Bordi për SHAL44 e cila do të tenderohet në vitin 2019 dhe është bërë identifikimi i aseteve që do të përfshihen në SHAL45.

Opinion i ligjor për tërheqjen e të gjitha aseteve me vendime të plotfuqishme në gjykata, vendimi i Bordit për tërheqje nga shitja e aseteve që kanë kërkesë për tërheqje në DHPGJS, vendimet e shpronësimeve dhe Vendimet për kthim të pronave në pronësi të komunave kanë bërë që gjatë këtij viti të tërhiqen nga shitja 55 aseteve.

Përgatitja e shitjeve nënkupton edhe përgatitjen e të gjitha dokumenteve përcjellëse të cilat kalojnë nëpër shqyrtim kadastral dhe ligjor, duke filluar nga:

- Raporti i Vizitave në Terren;
- Memorandumet e Informimit për Bord;
- Të Dhënat për Ndërmarrjen në Likuidim;
- Përshkrimet e Shkurta;
- Memorandumet e Informimit;
- Dokumente të Caktuara Ligjore dhe Rreziqet Tjera; si dhe

- Bazën e të Dhënave për propozimet e mundshme të investimeve.

Gjatë vitit 2018 janë dorëzuar tek blerësit **121** kontrata të shitjeve tek blerësit, asete këto që kanë qenë të përfshira nga SHAL37 deri më SHAL 40.

8.2. ADMINISTRIMI I ASETEVE

Agjencia sipas mandatit të saj, nga viti 2002 deri më 31 dhjetor 2018 ka administruar dhe kërkon të administroj (duke përfshirë asetet jashtë territorit të Kosovës) me gjithsej 3,994 asete të Ndërmarrjeve Shoqërore. Ky numër paraqet numrin e të gjitha aseteve të shitura dhe të pashitura të cilat janë identifikuar nga ana e Agjencisë brenda Republikës së Kosovës dhe jashtë Republikës së Kosovës. Më poshtë janë paraqitur të dhënat në mënyrë tabelare të aseteve sipas territorit apo llojit të tyre nga viti deri më 31 dhjetor 2018.

Asetet e mbetura (të pashitura) me të cilat ende administron AKP-ja janë gjithsej 2,196, ndërsa asetet jashtë Kosovës janë 162 asete të Ndërmarrjeve Shoqërore pa e përfshirë asetet e Trepçës. Gjithsesi, ky numër mund të ndryshoj në periudhat pasuese, varësisht në ndërrimin e statuseve të NSh-ve apo identifikimit të aseteve të NSh-ve përkatëse.

RAPORTI PËRMBLEDHËS I ASETETE TË PASHITURA BRENDA KOSOVËS

Tabela 1 - Numri i aseteve të pashitura sipas kategorisë dhe rajonit

	1	2	3	4=sum(1:3)	=4/total
Rajoni	Asetet tjera	Tokat bujqësore	Tokat tjera	Gjithsej	
Prishtina	254	207	59	520	24%
Peja	221	238	106	565	26%
Prizren	106	358	11	475	22%
Gjilan	41	174	28	243	11%
Mitrovica	196	167	30	393	18%
Gjithsej	818	1144	234	2196	100%

Tabela 2 - Numri i aseteve të pashitura jashtë Kosovës

Regjioni	Asetet tjera	Tokat bujqësore	Tokat tjera	Gjithsej
Bosne	14	-	1	15
Kroaci	5	-	-	5
Mal të Zi	34	-	1	35
Maqedoni	6	-	1	7
Slloveni	1	-	-	1
Serbi	99	-	-	99
Gjithsej	159	-	3	162

Tabela 3 - Asetet e pashitura brenda dhe jashtë Kosovës

		Kosovë		Jashtë Kosovës		Gjithsej	
Nr.	PËRSHKRIMI	Nr. NSh-ve	Asetet e pashitura	Nr. NSh-ve	Asetet e pashitura	Nr. NSh-ve	Asetet e pashitura
1	Në likuidim - asete të pashitura	319	2001	37	128	356	2129
2	Në transicion - asete të pashitura	60	195	1	34	61	229
Gjithsej		379	2196	38	162	417	2358

Gjatë kësaj periudhe lidhur me këto asete, AKP-ja kryesisht ka administruar lidhur me: përgatitjen e aseteve për shitje, administrimin e qirave, trajtimin e aseteve të uzurpuara, në koordinim me institucionet – shpalljen e interesit publik, kontestet gjyqësore dhe të tjera.

IDENTIFIKIMI I ASETEVE TE REJA

- Vetëm këtë vit kemi identifikuar dhe kemi vënë nën administrim të AKP-së 22 asete të reja, që më herët nuk i kishim në regjistër të Agjencisë;
- Gjatë vitit 2018 është arritur që në bazë të vendimeve të gjykatës të kthej pronën e NSH “Des Bratsfo” me sipërfaqe për 6,010 m², dhe dy prona të N.Sh. “Lavertari Blegtori” Prizren me sipërfaqe prej 19,106 m², nga pronësia private në emër të NSH-ve përkatëse.

IDENTIFIKIMI I ASETEVE TË MBETURA ME PROBLEME

Gjatë këtij viti në sistemin e menaxhimit të aseteve ku janë të identifikuara asetet e mbetura, për secilin aset është bërë identifikimi i problemeve dhe përmbledhja është paraqitur si në vijim:

Tabela 4 - Identifikimi i aseteve të mbetura me probleme

Rajoni	Prishtinë	Pejë	Prizren	Gjilan	Mitrovicë	Gjithsej	%
Vendim të Qeverisë	6	37	16	39	63	161	6.8%
Masë të Përkoshme	41	31	9	7	3	91	3.8%
Opinion i DHPGJS	-	-	9	6	5	20	0.8%
>10 ha	2	32	26	51	40	151	6.4%
Strategjike	1	2	1	7	8	19	0.8%
Mungesë e dokumentacionit	2	7	-	28	30	67	2.8%
Tranzicion	96	28	-	-	36	160	6.8%
Parcelim	5	73	21	72	40	211	8.9%
KNI	60	72	46	45	39	262	11.1%
Problem Pronësor / Kadastral	198	174	139	61	194	766	32.4%
Heqje Dore	32	57	21	33	19	162	6.8%
Komesacion	2	31	-	6	30	69	2.9%
Kulture mal	-	66	24	17	9	116	4.9%
Trashëgimi Kulturore	1	-	-	1	1	3	0.1%
Mosbashkëpunim me Komuna (lëshim i certifikatave)	2	-	-	41	64	107	4.5%
Gjithsej	448	610	312	414	581	2,365	100.0%

8.3. ASETET E LËSHUARA ME QIRA

Edhe gjatë kësaj periudhe pjesë thelbësore e strategjisë, sa i përket menaxhimit të aseteve, ka qenë edhe dhënia me qira e aseteve.

AKP-ja menaxhon me një numër të madhë të aseteve apo të NSh-ve që janë të mëdha dhe komplekse të tilla si NSh Grand Hotel, NSh ABC Genci dhe NSh Tregu dhe deri me 11 shtator ka menaxhuar edhe me NSh Pallati i Rinisë.

Përveç menaxhimit me NSh-të e mëdha dhe komplekse, duke marrë parasysh gjendjen ekonomike në Kosovës dhe sistemin gjyqësor në Kosovë, implementimi i politikave në dhënien me qira të aseteve për AKP-në ka qenë sfidë në vete.

Gjithsesi, marrë parasysh këta faktor, AKP-ja ka inkasuar qira në nivel të kënaqshëm prej EUR 6,268,014 dhe atë:

1. Qiraja e inkasuar për NSh-të në likuidim prej EUR 4,658,898;
2. Qiraja e inkasuar për NSh-të në tranzicion prej EUR 1,609,116.

Vlen të theksohet se impakt të rëndësishëm në inkasimin e qiras për kuartalin e fundit të vitit 2018 ka pas mos faturimi, rrjedhimisht mos inkasimi i të hyrave nga qiraja të NSh Pallati i Rinisë për arsye se nga data 11 shtator 2018, kjo ndërmarrje me vendim të Kuvendit të Republikës së Kosovës nuk administrohet rrjedhimisht nuk inkason të hyra për këtë periudhë.

Sipas raporteve të departamenti të Financave nëse nuk llogarisim inkasimin e qirave për NSh Pallati i Rinisë për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2018, atëherë performanca e qirasë kundrejt vitit 2017 do të ishte me rritje prej 8.67% apo €429 mijë. Ndërsa kundrejt vitit 2016 do të ishte prej 6% rritje apo €286 mijë.

Gjatë këtij viti janë dërguar në përmbarrim gjithsej 177 raste të qiramarrëseve që kanë qenë pagues të parregullt.

8.4. TRAJTIMI I ASETETEVE TË UZURPUARA

Zyrat rajonale vazhdimisht e kanë punuar intensivisht në lirim të pronave të uzurpuara mirëpo gjatë këtij viti përveç uzurpimeve janë ndërmarr edhe veprime për qiramarrës të cilët nuk kanë qenë të rregullt në pagesa.

Me anë të asistencës së policisë ku gjithsej janë procesuar 63 kërkesa për asistencë të policisë kurse prej tyre 16 janë anuluar pasi që qiramarrësit i kanë shlyrë borxhet.

Nga të gjitha asetet e uzurpuara ka mbetur vetëm një aset në Mitrovicë e Veriut për të cilin do të ndërmerren veprime në vitin vijues.

8.5. PËRCAKTIMI STATUSIT TË NSh-ve

Gjatë këtij viti janë procesuar dhjetë (10) Kërkesa për Përcaktimin e Statusit (SDR) për Asetet e NSh-ve me seli jashtë Kosovës për të cilat është siguruar dokumentacion, për shqyrtim nga Komisioni për Shqyrtimin dhe Përcaktimin e Statusit të NSh-ve.

8.6. QIRADHËNIA E PRONAVE TË NSh-ve

Zyret rajonale kanë përgatit dhe kanë marr aprovim nga kryesuesit e AL-ve dhe Menaxhmentit, dhe Bordi i Drejtorëve për qiradhënie të pronave të NSh-ve në përputhje me Rregulloren e Qiradhënies, dhe janë bërë shpalljet për qiradhënie për 272 asete në total prej tyre më 11 qershor 2018 ku janë përfshirë gjithsej 6 asete në tranzicion, më 13 qershor mars 2018 ku janë përfshi 82 asete, më 31 gusht 2018 ku janë përfshirë 88 asete, më 29 gusht 2018 ku janë përfshi 13 asete, më 24 dhjetor 2018 ku janë përfshirë 76 asete dhe me datën 26 dhjetor 2018 ku janë përfshirë 6 asete në tranzicion.

9. DEPARTAMENTI LIGJOR

Njësia e Opinioneve Ligjore dhe Shqyrtimit të Kontratave të Shitjes - ka zhvilluar aktivitete të ndryshme, por që kryesisht konsistojnë në dhënien e mendimeve dhe këshillave ligjore, hartimin e dokumenteve juridike rregullore apo akte tjera juridike) shqyrtimit të kontratave të shitjes si dhe pjesëmarrjen në takimet e ndryshme. Përmbledhja e aktiviteteve të NJOL gjatë periudhës raportuese, është paraqitur si në vijim: Opinione Ligjore të kërkuara me Kërkesë për Veprim apo nga Menaxhmenti 20; Hartimi, shqyrtimi apo analizimi i dokumenteve të ndryshme 11; Takimet në të cilat është kërkuar pjesëmarrja e zyrtarëve ligjorë 66; Kontrata e shqyrtuara të Shitjes me Likuidim 122; Kontrata e shqyrtuara me Negocim Direkt 33.

Njësia për Çështjet Gjyqësore - Numri i përgjithshëm i lëndëve të pranuar: 1827 (Veprimet procedurale të ndërmarr në lëndë: Mbrojtje në padi 729; Kundërpërgjigje 172; Përgjigje në ankesë 165; Parashtrësë 101; Seanca Gjyqësore 119; Urdhëra të pranuar 227; Ankesa 53; Përgjigje në urdhër 75; Përgjigje në masë të përkohshme 32; Aktvendim 121; Aktgjykim 115). Veprimet procedurale të ndërmarr nga Njësia e Përfaqësimeve Gjyqësore, në çështjet lidhur me listat e punëtorëve. Numri i përgjithshëm i lëndëve të pranuar: 321. Veprimet procedurale të ndërmarr në lëndë: Përgjigje në urdhër 16; Pjesëmarrje në seancë gjyqësore 29; Ankesa 211; Padi 37; Aktgjykim 19; Parashtrësë 19; Aktvendim 19.

Njësia për Trajtimin e Aseteve Jashtë Kosovës - Ankesa 5; Pjesëmarrje në seancë gjyqësore 18; Parashtrës 3; Padi 2; Aktgjykim 3; Aktvendim 3; Vendime të Organeve (në procedurën gjyqësore dhe administrative) të shteteve të huaja 2.

10. DEPARTAMENTI I MARKETINGUT, MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN DHE INVESTITORËT

Në përputhje me rolin që ka dhe funksionet primare të cilat janë të lidhura ngushtë me shitjen si proces, shtylla kryesore e angazhimit të Departamentit të Marketingut, Marrëdhënie me Publikun dhe Investitorë gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2018 ishte të siguroj përkrahje të plotë për të gjitha shitjet e realizuara nga AKP-ja si dhe menaxhimit të raporteve të mira me publikun dhe investitorët. Njëkohësisht, Departamenti ka siguruar përkrahje të plotë në promovimin e punës së Agjencisë, edukimin e publikut në lidhje me punën e Agjencisë si në nivel lokal, ashtu edhe në atë ndërkombëtarë, si dhe hartimin dhe menaxhimin e fushatave specifike të sektorit informativ të Agjencisë, në drejtim të implementimit të strategjisë për Medie dhe Marrëdhënieve me Publikun.

Në aspektin e realizimit të shpalljes së shitjeve janë zhvilluar dhe zbatuar plane multi-mediale marketingu, përfshirë përdorimin e mjeteve të duhura mediale, në përputhje me strategjinë për marketing masiv. Janë ndërmarrë aktivitete operacionale që përfshinë lansimin e shitjeve, realizimin e materialeve të duhura promovuese si dhe janë ofruar shërbime këshilluese për të gjithë investitorët e interesuar të marrin pjesë në procesin e Privatizimit.

Me qëllim të ngritjes së vizibilitetit dhe shpërndarjes së informatës tek publiku i gjerë dhe palët e interesit, si dhe promovimit të procesit të privatizimit tek investitorët potencial lokal dhe ndërkombëtar, Departamenti ka përfaqësuar Agjencinë në ngjarje dhe aktivitete relevante.

Aktivitetet e realizuara gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2018 janë si në vijim:

1. **Përkrahja e plotë në shpallje të Shitjeve të Aseteve** – Gjatë periudhës raportuese janë aplikuar praktikat e deritanishme të informimit publik përmes aktiviteteve mbështetëse për shpalljen e shitjeve, në drejtim të implementimit të strategjisë së marketingut masiv në kombinim me aktivitete të marketingut direkt, për çdo Shitje të Aseteve që është shpallur (SHAL39, SHAL40, SHAL41, SHAL42 dhe SHAL43). Pasi që shitjet kanë filluar në muajin korrik të vitit 2018, ka pasur rritje të prezencës në media, përfshirë rritjen e numrit të transmetimeve të TV reklamës dhe numrit të radiove lokale, në krahasim me praktikat e deritanishme.

2. **Ngritja e vizibilitetit dhe promovimit të procesit të privatizimit** – Në kuadër të aktiviteteve promovuese është bërë realizimi i të gjitha produkteve të marketingut të cilat kryhen brenda departamentit, përfshirë konceptimin, dizajnin dhe realizimin teknik të 6 (gjashtë) TV reklamave, shpalljeve të shtypura, broshurave, prezantimeve dhe të gjitha materialeve tjera promovuese. Njëkohësisht, është bërë konceptimi dhe hartimi i artikujve të sponsorizuar për publikim në media dhe portale rreth procesit të privatizimit dhe rëndësisë së këtij procesi për ekonominë e vendit.

3. **Përmirësimi i imazhit të Agjencisë** – Marrë parasysh trendet dhe zhvillimet e fundit në marketingun digjital, Agjencia ka rritur prezencën në media sociale, ku gjatë periudhës raportuese janë bërë 92 postime në rrjetet sociale si dhe rreth 108 përgjigje për palët të cilat janë adresuar përmes këtij kanali të komunikimit, ndërkaq ka pranuar dhe adresuar rreth 219 pyetje dhe kërkesa në emailin zyrtar të AKP-së info@pak-ks.org. Konkretisht, gjatë periudhës janar-dhjetor 2018 Agjencia ka zhvilluar dhe implementuar katër (4) fushata në rrjetet sociale me ç'rast janë prezantuar rezultatet e punës për të ngritur imazhin e AKP-së.

4. **Ngritja e transparencës dhe nivelit të informimit përmes azhurnimit dhe popullimit të ueb-faqes së AKP-së me informata të sakta dhe në kohë reale.**

5. **Përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimeve të ofruara për investitorët potencial** – Njësia e Marketingut dhe Marrëdhënie me Investitorë ka vazhduar të mbetet pika primare e komunikimit me investitorët potencial vendor dhe ndërkombëtar, duke u përgjigjur kërkesave dhe ofruar udhëzime dhe këshillime rreth procesit të privatizimit dhe pjesëmarrjes në tenderët e shpallur, përfshirë koordinimin e hulumtimit paraprak dhe sigurimin e materialeve tenderuese (Rregullat e Tenderit, Memorandume Informimi etj.).

6. **Regjistrimi dhe menaxhimi efektiv i bazës së të dhënave të investitorëve. Për qëllime marketingu në vazhdimësi është bërë regjistrimi dhe popullimi i databazës së investitorëve potencial, të cilët njoftohen në vazhdimësi mbi shpalljet e Shitjeve të Aseteve përmes e-mailit dhe SMS shërbimit.**

7. Rritja e rrjedhës së informatave

- Gjatë këtij viti janë përgatitur rreth 61 përgjigje me shkrim të dërguara përmes emailit në pyetje të gazetarëve të medie të ndryshme;
- Hartimi i rreth 28 Komunikatave për Media për aktivitetet e ndryshme të Agjencisë, të cilat janë dërguar për publikim tek mediat dhe përmes tyre janë shpërndarë tek opinioni i gjerë;

- Përpilimi i raporteve për Ministrinë e Integritetit Evropiane lidhur me zbatimin e planit kombëtar për zbatim të MSA-së, pra raportin vjetor të AKP-së për 2018;
- Janë përgatitur raporte të rregullta (çdo tre muaj) dhe këto raporte i janë dërguar njësisë përkatëse

të Qeverisë së Kosovës/Zyrës së Kryeministrit, e cila përgatit raportin gjithëpërfshirës të institucioneve publike, për realizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike.

Numri i kërkesave të pranura 2018					
Numri total	Qasja e lejuar	E refuzuar	E kufizuar	Pa përgjigje	Tjera
19	12	7	0	0	

11. DEPARTAMENTI I BURIMEVE NJERËZORE

Gjatë periudhës raportuese në Departamentin e Burimeve Njerëzore janë zhvilluar aktivitetet si në vijim:

- Janë bërë të gjitha ndryshimet e nevojshme në Akte të Emërimit të nëpunësve të AKP-së për rritjen e pagave prej 4% bazuar në vendimin e Kryeministrit të RKS me nr. 05/24;
- Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave ka shqyrtuar dhe ka marrë Vendim për tetëmbëdhjetë (18) ankesa;
- Komisioni Disiplinor ka shqyrtuar dhe ka marrë vendim për një (1) rast që ka rezultuar me shkëputjen e marrëdhënies së punës së një zyrtari;
- Gjatë vitit 2018, janë realizuar gjithsej katërmëdhjetë (14) trajnime ku numri total i pjesëmarrësve ka qenë 46;

- Përpilimi i Raportit vjetor i Evaluimit të Vlerësimit të Performancës për vitin 2017;
- Përpilimi i Raportit Vjetor të realizimit të Planit të Trajnimeve për vitin 2017;
- Përpilimi i Planit Vjetor të Trajnimeve për vitin 2018;
- Është iniciuar procesi i vlerësimit të performancës për periudhën janar-dhjetor 2018, caktimin e objektivave për periudhën janar-dhjetor 2019 si dhe Plani i trajnimit për vitin 2019.

11.1. REKRUTIMET DHE LËVIZJET E STAFIT

Gjatë kësaj periudhe, DBNJ ka udhëhequr me procedurat e rekrutimit për njëzet e pesë (25) procese dhe lëvizjet e stafit.

12. DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS

Në kuadër të Departamentit të Administratës bëjnë pjesë këto njësi: Njësia e Shkresave Gjyqësore, Njësia e Përkthimeve, Njësia e Protokollit, Njësia e Teknologjisë Informative, Njësia e Arkivit, Njësia e Shërbimeve të Përgjithshme dhe Njësia e Transportit.

Aktivitetet kryesore për këtë periudhë të raportimit për njësitë përkatëse, paraqiten si më poshtë:

12.1. NJËSIA E SHKRESAVE GJYQËSORE

- Gjatë kësaj periudhe janë regjistruar **3605** kërkesa;

- Janë regjistruar të reja **1938** lëndë dhe **1667** bashkëngjitje të lëndëve ekzistuese;
- **49** Njoftime për iniciimin e procedurës gjyqësore në Dhomën e Posaçme;
- **5749** fajllime elektronike dhe fajllime fizike të lëndëve të reja hyrëse/dalëse dhe dokumenteve shtesë;
- Përgatitja e **2627** dërgesave për Dhomën e Posaçme dhe **40** dërgesa palëve, si dhe janë fotokopjuar për çështje që lidhen me punët e lartpërmendura **40 084** faqe.

12.2. NJËSIA E PËRKTHIMEVE

Njësia e Përkthimeve ka përkthyer **631** dokumente me **4,768** faqe dhe ka siguruar përkthyesit për 9

takime.

12.3. NJËSIA E PROTOKOLIT

Gjate kësaj periudhe, në këtë njësi janë pranuar/dërguar dhe proceduar dokumentet si në vijim:

- Të regjistruara në sistem hyrje/dalje janë **10375**;
- Dokumente dhe shkresa hyrëse **5702**;
- Shkresa dalëse nga kjo zyrë janë regjistruar **4673**;
- Të skanuara **10375**;
- Pranimi me Postë **634**;
- Dërgimi me Postë **713**;
- Dërgimi me libër të ekspedicionit brenda AKP-së **5702**;
- Dërgimi me Libër jashtë AKP-së **154**;
- Shkresa të Dhomës së Posaçme të identifikuar për Autoritetin e Likuidimit **1257**.

12.4. NJËSIA E TEKNOLOGJISË INFORMATIVE

Edhe viti 2018 është karakterizuar me një stabilitet të qëndrueshëm të sistemit. Duke marrë parasysh që roli i TI-së është në ofrimin e shërbimeve të vazhdueshme elektronike, Njësia e TI-së ka ndërmarr shumë masa parandaluese të cilat kanë rezultuar në shërbime kualitative të pandërprera dhe ndër më kryesoret mund të cekën pikat në vijim:

- Tranzicioni i shërbimeve të fotokopjeve në sistemin e ri (nga AQP);
- Blerja dhe konfigurimi i DVR-sistemit të ri të kamerave;
- Importimi i arkivave lokale të Outlookut në Barracuda Message Archiver;
- Instalimi i serverit të ri (Dell PowerEdge 630);
- Konfigurimi dhe upgrade i sistemit të vjetër SAN (storage area network) në sistem të ri (EMC VNX3300 në DELL EMC Unity300);
- Konfigurimi dhe upgrade i sistemit të vjetër backup (DataDomain 160 në Data Domain DD3300 Data Protection).

12.5. NJËSIA E ARKIVIT

- Dokumentacioni i skanuar, regjistruar dhe arkivuar për Departamentin e Shitjes, 129 kuti me 347 oferta të shitjes;
- 245 regjistratorë të regjistruar dhe arkivuar të Departamenteve të ndryshme të AKP-së;
- Futja e të dhënave në softuerin e Arkivit për 374 regjistratorët e skanuar, regjistruar dhe arkivuar;
- Arkivimi elektronik i 194 vendimeve të DM-së;
- Arkivimi i 47 kontratave të shitjes përmes Likuidimit;
- Azhurnim në dokumentacionin para-kualifikues, gjithsej 6 azhurnime;
- Kërkesat për sigurimin e kopjes së kontratës (të noteruar) të privatizimit, gjithsej 8 kërkesa.

12.6. NJËSIA E SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME

- Gjatë këtij viti kemi asistuar në lirim të pronave shoqërore në rajonin e Mitrovicës, Pejës, Prizrenit, Gjilanit dhe Prishtinës, në gjithsej 62 njësi aty ku është shfaqur nevoja;
- Janë protokolluar 464 fatura, të cilat janë përcjellë në Departamentin e Financave, prej tyre janë futur në SIMFK 420 Raporte;
- Kemi iniciuar 14 deklarata të nevojave pas analizave dhe hulumtimeve dhe kërkesave për nevoja të ndryshme të AKP-së të planifikuara me kohë;

12.7. ZYRA E TRANSPORTIT

- Gjatë kësaj periudhe kemi pasur 907 kërkesa për shërbime të rregullta të transportit dhe 1587 shërbime-kërkesa urgjente, të cilat janë mbuluar po ashtu;
- Ne servisim i kemi pasur 86 vetura dhe vazhdon procesi i servisimit dhe i kontrollimit të të gjitha veturave sipas nevojave;
- Janë nënshkruar ose proceduar deklaratat e nevojave për nevoja të transportit;
- Është bërë marrja me Qira-Leasing e 3 veturave të reja;

13. DEPARTAMENTI I FINANCE DHE BUXHETIT

Tabelat e paraqitura më poshtë janë një ekstrat i raporteve që janë marrë nga pasqyrat financiare për Buxhetin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Fondeve në Mirëbesim. Pasqyrat financiare së bashku me shënimet shpjeguese janë në shtojcën e këtij raporti. Paqyrat financiare për Buxhetin e AKP'së të dorëzuar në Ministrinë e Financave janë sipas formatit të përcaktuar me rregulloren në fuqi të Ministrisë së Financave. Ndërsa pasqyrat financiare të fondeve në mirëbesim janë në pajtim me rregulloren e Bordit të Drejtorëve të AKP'së.

13.1. FINANCIMI I AKTIVITETEVE OPERATIVE DHE

ADMINISTRATIVE TË AKP-së

Aktivitetet operative dhe administrative të AKP'së, financohen nga të hyrat e dedikuara të realizuara nga 5% e shitjeve të aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore. Për më tepër shih nenin 21 të Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Pasqyrat financiare janë pjesë e këtij raporti të cilat janë të bashkangjitur në Shtojcë

PËRSHKRIMI	REN-DITJA	BUXHETI ORIGINAL (LIGJI NR. 06/L -020)	BUXHETI I RISHIKUAR GJYSMËV-JETOR (NUK KA PASUR)	BUXHETI I APROVUAR PËR PERI-UDHËN DERI MË 31 DHJETOR 2018	PAGESAT	%	%
		a	b	c	d	e=d/a	f=d/c
Gjithsej	1+2	7,796,736	-	7,261,736	6,282,977	81%	87%
Pagat dhe medijtjet		4,728,736	-	4,728,736	4,619,829	98%	98%
Mallrat dhe Sherbimet		2,830,000	-	2,280,000	1,446,103	51%	63%
Shpenzimet Komunale		98,000	-	98,000	74,069	76%	76%
Subvencione dhe Transferet		40,000	-	55,000	52,540	131%	96%
Investimet Kapitale		100,000	-	100,000	90,436	90%	90%
Granti i Përgjithshëm 2018	1	550,000	-	15,000	-	0%	0%
Mallrat dhe Sherbimet		550,000	-	15,000	-	0%	0%
Të hyrat e dedikuara 2018	2	7,246,736	-	7,246,736	6,282,977	87%	87%
Pagat dhe medijtjet		4,728,736	-	4,728,736	4,619,829	98%	98%
Mallrat dhe Sherbimet		2,280,000	-	2,265,000	1,446,103	63%	64%
Shpenzimet Komunale		98,000	-	98,000	74,069	76%	76%
Subvencione dhe Transferet		40,000	-	55,000	52,540	131%	96%
Investimet Kapitale		100,000	-	100,000	90,436	90%	90%

13.2. PROCESI I FONDEVE NË MIRËBESIM – NDËRMARRJET SHOQËRORE

PËRSHKRIMI	2003 DERI MË	PERIUDHA 1 JANAR	2003 DERI MË
	31 DHJETOR 2017	31 DHJETOR 2018	31 DHJETOR 2018
PRANIMET NË LLOGARITË BANKARE			
Të hyrat nga shitjet	697,169,916	18,138,724	715,308,640
Të hyrat nga qiraja	32,562,651	6,268,014	38,830,665
Interesi i fituar	34,844,700	-	34,844,700
Tarifa për pjesëmarrjen në tenderat e shitjes dhe konfiskimet e BID depozitave	8,229,964	652,400	8,229,964
BID depozitat e ofertuevse	2,030,820	(1,187,620)	843,200
Të hyra të tjera	6,866,535	397,439	7,263,974
Kapitali themeltar i Agjencisë	1,013,200	-	1,013,200
GJITHSEJ PRANIMET NË LLOGARITË BANKARE	782,717,786	23,706,457	806,424,243
PAGESAT/SHPËRNDARJA NGA LLOGARITË			
20% i punëtorëve transferuar në BSPK	119,257,304	6,970,480	126,227,784
Ofruesi i Shërbimeve Profesionale (Autoriteti i Likuidimit)	15,419,930	581,000	16,000,930
Mallra dhe shërbime	14,381,184	1,941,882	16,323,066
Shërbime publike	1,994,309	412,063	2,406,372
Tatimet	5,011,966	1,122,325	6,134,291
Vendimet e gjykatave/përmbauesve (depozita dhe taksa)	1,808,211	707,711	2,515,922
Transferimi i mjeteve 5% për mbulimin e aktiviteteve të AKP-së	38,248,000	6,493,706	44,741,706
Të tjera	749,541	37,650	787,191
Pagesat ndaj kreditorëve të NSh-së	23,977,884	2,476,127	26,454,011
Fondet tepriçë transferuar Qeverisë	90,570,575	86,146,458	176,717,033
GJITHSEJ SHPENZIMET/SHPËRNDARJA	311,418,904	106,889,402	418,308,306
Gjendja në llogaritë bankare	31 Dhjetor 2017	Hyrje/Dalje	31 Dhjetor 2018
BILANCI I PRANIMEVE DHE PAGESAVE	471,298,882	(83,182,945)	388,115,937

Të dhënat të paraqitura më lartë, paraqesin rezultat e pranimeve dhe pagesave në llogaritë bankare të NSh'ëve, të cilat AKP'ja i administron në Bankën Qendrore të Kosovës.

14. DEPARTAMENTI I PROKURIMIT

Në Departamentin e Prokurimit gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2018 janë nënshkruar 48 kontrata që kapin shumën prej 952,973.72€, duke përdorur procedurat e prokurimit në vijim:

- Procedura e prokurimit me vlerë të madhe;
- Procedura e prokurimit me vlerë të mesme;
- Procedura e negociuar pa publikimin e njoftimit për kontratë; si dhe
- Procedura e kuotimit të çmimit me vlerë të vogël dhe vlerë minimale.

Me poshtë gjeni ndarjen e kontratave sipas kategorive:

- Kontratë për shërbime - janë realizuar gjithsej 33
- Kontratë për furnizime - janë realizuar gjithsej 15

Janë edhe 4 lëndë prokurimi tjera në proces, që janë bartur në vitin 2019 për të vazhduar me procedurat tjera të prokurimit.

15. DEPARTAMENTI I KOMISIONEVE PROFESIONALE

15.1. KOMISIONI PËR SHQYRTIMIN E LISTAVE TË 20% TË PUNËTORËVE

Gjatë periudhës raportuese Janar-Dhjetor 2018, aktivitetet e Komisionit kanë qenë si në vijim:

Përshkrimi	Janar-Dhjetor 2018
Shuma e fondeve të shpërndara të 20%-it për punëtorët e NSh-ve	6,994,554
Vendime të formës së prerë të lëshuara nga DHPGJS	8
Numri i NSh-ve për të cilat është realizuar shpërndarja	73
Numri i punëtorëve për të cilët janë bërë pagesat	11,547

15.2. KOMISIONI PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE

NDAJ LISTAVE TË 20% TË PUNËTORËVE

Komisioni ka shqyrtuar 675 ankesa në listat e 20% të punëtorëve, për 9 NSH.

15.3. KOMISIONI PËR SHQYRTIMIN E ASETVE ME KARAKTER SPECIFIK

- Për gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2018, janë pranuar 160 kërkesa për negociim direkt, duke përjashtuar zyrën rajonale të Mitrovicës;
- Janë shqyrtuar dhe aprovuar nga Komisioni 88 kërkesa;
- Janë aprovuar 74 kërkesa nga Bordi i Drejtoreve me 7 vendime.

15.4. KOMISIONI PËR NEGOCIM DIREKT

Gjatë periudhës raportuese Janar-Dhjetor 2018, aktivitetet e Komisionit kanë qenë si në vijim:

Përshkrimi	Janar-Dhjetor 2018
Numri i vendimeve të pranuar nga KShAKS	8
Numri i rasteve të përfshira në vendime të BD	32
Numri i parashtrueseve të përfshirë	114
Numri i raporteve përfundimtare të dorëzuara në BD	9
Numri i rasteve në proces të shqyrtimit	20
Numri i rasteve të kthyera në KShAKS	3
Numri i rasteve në pritje	4
Numri i rasteve të përmbyllura	5
Numri i parashtrueseve për të cilët është përmbyllur negociimi direkt	48

15.5. KOMISIONI PËR KAKTIMIN E STATUSIT TË NDËRMARRJEVE – KPS

Gjatë periudhës raportuese Janar-Dhjetor 2018, në Komisionin për KPS, janë shqyrtuar dhe aprovuar në BD 47 KPS, të cilat janë në pronësi shoqërore dhe bien në kompetencat e AKP-së.

Deri më 31 Dhjetor 2018 janë edhe:

- 4 KPS në shqyrtim nga Komisioni
- 4 KPS në shqyrtim për aprovim/refuzim nga Bordi; dhe
- 1 KPS që nuk është dërguar ende në Komision.

15.6. KOMISIONI PËR SHITJEN E BANESAVE NË PRONËSI SHOQËRORE

Gjatë periudhës raportuese Janar-Dhjetor 2018,

aktivitetet e Komisionit kanë qenë si në vijim:

- Pranimi i 42 kërkesave të reja për blerjen e banesave;
- Bordi i Drejtorëve ka aprovuar 13 kërkesa për blerjen e banesave; refuzuar 12 kërkesa për blerjen e banesave; pezulluar 6 kërkesa për blerjen e banesave;
- Bordi i Drejtorëve është shpallur jo kompetent për 1 kërkesë për blerjen e banesave;
- Bordi i Drejtorëve ka shpallur e papranueshme 1 kërkesa për blerjen e banesave.

16. NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Në vazhdimësi paraqiten aktivitetet e NJAB-së për periudhën në fjalë:

1. Auditimi i Autoritetit të Likuidimit (AL):

duke u bazuar në planin e punës së NJAB-së, ky auditim ka filluar në muajin Nëntor të vitit 2017. Pasi që ky auditim ishte më kompleks, si dhe për shkak të vonesave në kompletimin e dokumentacionit nga Autoritetet e Likuidimit, finalizimi i raportit të këtij auditimi është bërë në fillim të vitit 2018;

2. Auditimi i Departamentit të Financave dhe Buxhetit (DFB):

Objektivat kryesore të këtij auditimi janë bazuar në vlerësimin e rrezikut, të cilat janë të ndërlidhura me veprimet e ndërmarra brenda Departamentit të Financave dhe Buxhetit. Për shkak të vonesave në kompletimin e dokumentacionit edhe ky auditim ishte finalizuar në fillim të vitit 2018;

3. Auditimi i Departamentit të Administratës (DA):

duke u bazuar në planin e punës së NJAB-it për vitin 2018, ky auditim ka filluar në muajin Janar. Objektivat kryesore të këtij auditimi janë bazuar në vlerësimin e rrezikut, të cilat janë të ndërlidhura me veprimet e ndërmarra brenda Departamentit të Administratës, përkatësisht njësitë përkatëse të këtij departamenti. Raporti final i këtij auditimi është shpërndarë tek Menaxhmenti në muajin Qershor;

4. Auditimi i Sekretariatit Ekzekutiv të Bordit të Drejtorëve (SEB):

duke u bazuar në planin e punës së NJAB-it për vitin 2018, ky auditim ka filluar në muajin Shkurt. Objektivat kryesore të këtij auditimi janë bazuar në vlerësimin e rrezikut, të cilat janë të ndërlidhura me veprimet e ndërmarra brenda SEB-it. Raporti final i këtij auditimi është shpërndarë tek Menaxhmenti dhe Bordi i Drejtorëve në muajin Maj;

5. Auditimi i Departamentit të Koordinimit Rajonal (DKR) dhe Zyrat Rajonale:

Objektivat kryesore të këtij auditimi janë bazuar në vlerësimin e rrezikut, të cilat janë të ndërlidhura me veprimet e ndërmarra brenda DKR-së dhe Zyrave Rajonale. Raporti final i këtij auditimi është shpërndarë tek Menaxhmenti dhe Bordi i Drejtorëve në muajin Shtator;

6. Auditimi mbi Përcjelljen e Implementimit të Rekomandimeve të Njesisë së Auditimit të Brendshëm (NJAB):

duke u bazuar në planin e punës së NJAB-it për vitin 2018, ky auditim ka filluar në muajin Korrik. Objektivat kryesore të këtij auditimi ka qenë që të siguroj Bordin e Drejtorëve, Menaxhmentin dhe palët me interes se rekomandimet e dhëna nga NJAB gjatë periudhës Janar 2015-Qershor 2018, janë implementuar ose është tentuar që të implementohen nga ana e Menaxhmentit të AKP-së, përkatësisht departamenteve dhe njësive përbërëse të Agjencisë. Finalizimi i këtij raporti është bërë në muajin Shtator dhe i njëjti është përcjellë tek Bordi i Drejtorëve;

7. Auditimi i Departamentit të Komisioneve Profesionale (DKP):

Objektivat kryesore të këtij auditimi janë bazuar në vlerësimin e rrezikut, të cilat janë të ndërlidhura me veprimet e ndërmarra brenda këtij departamenti (përkatësisht Komisionit të Negocimit Direkt të Shitjes së Aseteve dhe Komisionit për Ndërtime Joligjore). Finalizimi dhe shpërndarja tek Menaxhmenti e raportit final të këtij auditimi është bërë në muajin Nëntor;

8. Auditimi i Departamentit të Shitjes (Njësia për Përgatitjen e Kontratave të Shitjes dhe Kontratave me Negocim Direkt):

duke u bazuar në planin e punës së NJAB-it për vitin 2018, ka filluar auditimin e këtij departamenti. Objektivat kryesore të këtij auditimi janë bazuar në vlerësimin e rrezikut, të cilat janë të ndërlidhura me veprimet e ndërmarra brenda Njesisë për përgatitjen e kontratave të shitjes dhe kontratave me negocim direkt. Raporti final i këtij auditimi është shpërndarë tek Menaxhmenti në muajin Dhjetor;

9. Auditimi i Departamentit të Prokurimit (DP):

Objektivat kryesore të këtij auditimi janë bazuar në vlerësimin e rrezikut, të cilat janë të ndërlidhura me veprimet e ndërmarra brenda këtij departamenti. Ky auditim është finalizuar në muajin Dhjetor, ndërsa sipas procedurave raporti final i këtij auditimi është shpërndarë tek Menaxhmenti;

10. Auditimi i Departamentit të Financave dhe Buxhetit (DFB):

duke u bazuar në planin e punës së NJAB-it për vitin 2018, ka zhvilluar auditimin e këtij departamenti. Objektivat kryesore të këtij auditimi janë bazuar në vlerësimin e rrezikut, të cilat janë të ndërlidhura me veprimet e ndërmarra brenda DFB-së dhe Fondeve në Mirëbesim. Për shkak të disa procedurave, ky auditim ka mbetur të finalizohet në fillim të vitit 2019;

11. Auditim me kërkesë (OSHP-ja/Autoritetet e Likuidimit):

Me kërkesën e Bordit të Drejtorëve, NJAB ka kryer auditimin e aneksit 2 të kontratës së AKP-së me Ofruesin e Shërbimeve Profesionale (OSHP), përkatësisht për Njësine e Zbatimit të Projektit të Likuidimit dhe Autoritetet e Likuidimit. Ky auditim është kryer gjatë muajit Tetor, përderisa raporti/memo i/e auditimit është prezantuar para Bordit të Drejtorëve;

12. Përgatitja e raporteve mbi aktivitetet e NJAB-it për Njësine Qendrore Harmonizuese të Auditimit të Brendshëm (NJQHAB):

Duke iu referuar kërkesave ligjore, në muajin Janar, NJAB ka përgatitur dhe dorëzuar tek NJQHAB-ja

raportet mbi aktivitetet e saj për vitin 2017. Po ashtu gjatë periudhës raportuese NJAB-ja ka bërë raportimin mbi aktivitetet e kryera të sajë për periudhën Janar-Shtator 2018;

13. Hartimi i regjistrit të rrezikut të AKP-së për vitin 2018:

Gjatë periudhës raportuese është azhurnuar regjistri i rrezikut të Agjencisë dhe i njëjti është harmonizuar me objektivat e AKP-së për vitin 2018;

14. Auditimi i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF) për AKP-në dhe Fondet në Mirëbesim nga Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA):

Gjatë periudhës raportuese, Ekipi i Auditimit të ZKA-së ka kryer auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare të AKP-së dhe Fondeve në Mirëbesim, për vitin 2017. Në muajin Qershor, nga ZKA-ja kemi pranuar raportet finale të auditimit të PVF-ve të Fondeve në Mirëbesim dhe AKP-së për vitin 2017. Po ashtu, gjatë periudhës raportuese (gjatë periudhës Tetor-Dhjetor), Ekipi i Auditimit të ZKA-së ka kryer auditimet e ndërmjetme të PVF-ve të AKP-së dhe Fondeve në Mirëbesim për vitin 2018. ZKA-ja në fund të këtyre auditimeve të ndërmjetme nuk ka lëshuar ndonjë memo të auditimit;

15. Përgatitja e Planit të veprimit për implementimin e rekomandimeve të ZKA-së për vitin 2017:

Duke iu referuar kërkesave ligjore, pas pranimi të raporteve të auditimit nga ZKA-ja, në bashkëpunim me Menaxhmentin është përgatitur Plani i veprimit për implementimin e rekomandimeve të ZKA-së për vitin 2017. Ky plan, konform procedurave është dorëzuar tek ZKA-ja. brenda afateve të përcaktuara ligjore;

17. REKOMANDIMET PËRMBLEDHËSE PËR TË ARDHMEN

Agjencia, sa i përket kompetencave të saj, i ka përmbyshur objektivat e mëposhtme gjatë vitit 2018 siç janë:

- Planin e Riorganizimit;
- Fillimin e procesit të Shitjes – shpalljen e shitjeve. Strategjia që çdo muaj të shpallen shitjet;
- Monitorimin e shitjeve me “Spin Off Special” dhe Kushte të Veçanta;
- Shpërndarjen e 20% të punëtorëve; dhe
- Shpërndarjet për kreditorët e NSH-ve në likuidim;

Për periudhën e ardhshme, Agjencia Kosovare e Privatizimit rekomandon që të ndërmerren veprimet nga Qeveria apo Kuvendi lidhur pesë veprimet e mëposhtme të cilat janë për përmbushjen e misionit sipas Ligjit mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Pikat e paraqitura më poshtë që AKP-ja rekomandon të trajtohen me prioritet janë si më poshtë:

1. Mënyra e Financimit të aktiviteteve të AKP-së. Aktualisht AKP-ja financohet nga të hyrat e dedikuara sipas neni 21 të Ligjit nr. 04/L-034. Sipas këtij neni, 5% e të shitjeve janë të hyra të dedikuara. Maksimum, deri në gjysmë-vjetorin e parë të vitit 2019, AKP-ja do të ketë mjete në dispozicion për të mbuluar aktivitetet e saja operative dhe administrative. AKP-ja sugjeron që të trajtohet me prioritet mënyra e financimit të aktiviteteve të AKP-së apo të ndryshohet neni 21 i Ligjit të AKP-së nga 5% në 7%.
2. Ngritjen e kapaciteteve në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe Gjykatave Themelore. Ngritja e kapaciteteve ndikon në çështjet e mëposhtme:

- 1.1. **Shitja** - Kontestet gjyqësore të pronësisë;
- 1.2. **20% e punëtorëve** - Realizimin e shpërndarjes të tërë 20% të punëtorëve pas zgjidhjes të kontesteve gjyqësore të ankesave;
- 1.3. **Shpërndarjen e mjeteve ndaj kreditorëve** - Zgjidhjen e pretendimeve të kreditorëve. Zgjidhja e këtyre kontesteve mundëson përmbylljen e procesit të likuidimit.
3. Komunitat të jenë më bashkëpunues apo të miratohet një rezolutë nga Kuvendi, si një mekanizëm e cila do të obligonte komunitet që të jenë bashkëpunues me të gjitha shërbimet të cilat ndërlidhen me asetet e Ndërmarrjeve Shoqërore.

18. RAPORTI I ADRESIMIT TË REKOMANDIMEVE NGA ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT PËR AUDITIMIN E VITIT 2017

18.1. RAPORTI I ADRESIMIT TË REKOMANDIMEVE PËR BUXHETIN E AKP-së

Nr.	Neni në raport	Faqe	Referencë	Rekomandimi i Auditorit të Përgjithshëm	Departamenti përgjegjës për zbatim	Afati për zbatim	Komentet
1.	2.3	10	Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Vjetore Financiare lidhur me Pasqyrat Vjetore Financiare	Kryesuesi i Bordit: Duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes, duke ndërmarrë veprime specifike për t'i eliminuar gabimet në klasifikimin e shpenzimeve. Agjencia duhet të ndryshojë rregulloren e brendshme për kompensimin e drejtorëve të bordit të Agjencisë, e me pas të gjitha shpenzimet duhet të buxhetohen dhe evidentohen në përputhje me planin kontabël, bazuar në kërkesat e ligjit të buxhetit.	128	356	2129
2.	2.3	10	Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Vjetore Financiare	Kryesuesi i Bordit: Duhet të siguroj prezantimin e drejtë dhe të plotë të informatave në pasqyra financiare përfshirë buxhetin final dhe shpalosjet e pasurive e detyrimeve. Gjithashtu, duhet vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV-ve për vitin 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj pasqyrave financiare vjetore janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.	34	61	229
3.	3.4	14	Menaxhimi i personelit	Kryesuesi i Bordit: Duhet të ndërmarrë veprime shtesë për të ndërprerë mbulimin e pozitave menaxheriale me U.D. Kohëzgjatja e funksionit si U.D. të mos jetë më e gjatë se periudha e përcaktuar ligjore, pasi që ka ndikim vendimtar për funksionimin e kontrolleve dhe arrijten e objektivave.	-Menaxhmenti; -Departamenti i Burimeve Njerëzore	31 dhjetor 2018 (Në vazhdimësi)	Adresimi i pozitave menaxheriale të mbuluara me ushtrues detyre ka qenë fokus gjatë tërë vitit 2018 me ç'rast është arritur që të plotësohet ato pozita të lira për të cilat ka qenë i mundur inicimi i procesit të rekrutimit. Mbetet e njëjtë situata për ato pozita për të cilat zyrtarët bartës të atyre pozitave janë të suspenduar. Andaj, AKP-ja është e detyruar që të vazhdojë me U.D edhe në të ardhmen, deri në përfundimin e proceseve gjyqësore ndaj zyrtarëve të suspenduar. Momentalisht numri total i zyrtarëve me ushtrim të detyrës (U.D) është gjashtë (6).
4.	3.8	15	Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale	Kryesuesi i Bordit: Duhet të siguroj një bashkëpunim efektiv në mes të njërive të cilat i procedojnë kërkesat dhe departamentit të prokurimit gjatë procesit të planifikimit. Kjo duhet të përfshijë kohën e nevojshme kur duhet të zhvillohen proceset e prokurimit e ndërlidhur me buxhetin e ndarë për Agjencinë.	-Menaxhmenti; -Departamenti i Prokurimit dhe Njësitë përkatëse brenda AKP-së.	31 dhjetor 2018 (Në vazhdimësi)	
5.	3.8	16	Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale	Kryesuesi i Bordit: Duhet të siguroj që realizimit të kontratave duhet t'i paraprijë një plan detal për menaxhimin e kontratave me qëllim që të shmangen mangësitë në realizimin e projekteve.	-Departamenti i Prokurimit; -Njësitë përkatëse brenda AKP-së.	31 dhjetor 2018 (Në vazhdimësi)	Kjo e gjetur tanimë është adresuar në tërësi. Secila kontratë e ka edhe Menaxherin e Projektit si dhe planin e menaxhimit të kontratës.


Nr.	Neni në raport	Faqe	Referencë	Rekomandimi i Auditorit të Përgjithshëm	Departamenti përgjegjës për zbatim	Afati për zbatim	Komentet
6.	3.9	16	Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryesuesi i Bordit: Duhet të siguroj që regjistri i stoqeve azhurnohet rregullisht, duke përfshirë evidencat e sakta për të gjitha blerjet dhe daljet e tyre në mënyrë që regjistrat e tyre të jenë të plotë dhe të saktë në çdo kohë. Evidencat e sakta të stoqeve përveç nevojave të raportimit për pasqyrat financiare vjetore ato janë të nevojshme edhe për nevojat e brendshme të menaxhmentit.	-Menaxhmenti; -Departamenti i Administratës; -Departamenti i Financave dhe Buxhetit.	31 dhjetor 2018	Kjo e gjetur është adresuar dhe tashmë kemi evidencë të plotë të stoqeve dhe pasurive të AKP-së.
7.	4	18	Progresi në zbatimin e rekomandimeve	Kryesuesi i Bordit: Duhet të siguroj që zbatimi i planit të veprimit, po fiton ritmin e nevojshëm dhe po monitorohet në vazhdimësi në baza të rregullta në lidhje me progresin e arritur në këtë drejtim. Rekomandimet që kanë mbetur ende të papërfunduara, të rishikohen në një afat të shkurtër, si dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.	-Menaxhmenti; -Departamentet dhe Njësitë përkatëse brenda AKP-së.	31 dhjetor 2018 (Në vazhdimësi)	Menaxhmenti përgjatë gjithë vitit e bën azhurnimin e planeve të adresimit të rekomandimeve të ZKA-së. Po ashtu, në vazhdimësi bëhet edhe monitorimi i zbatimit të këtyre planeve.
8.	5.2	21	Raportimi menaxheria, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut	Kryesuesi i Bordit: Duhet të sigurojë se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut nëpër sektorët përkatës dhe të sigurojë monitorim efektiv dhe raportim tremujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë.	-Bordi i Drejtorëve; -Menaxhmenti; -Departamentet dhe Njësitë përkatëse brenda AKP-së.	31 dhjetor 2018 (Në vazhdimësi)	

18.2. RAPORTI I ADRESIMIT TË REKOMANDIMEVE PËR FONDET NË MIRËBESIM PËR AUDITIMIN E VITIT 2017

Nr.	Neni në raport	Faqe	Referencë	Rekomandimi i Auditorit të Përgjithshëm	Departamenti përgjegjës për zbatim	Afati për zbatim	Komentet
1.	2.2	10	Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryesuesi i Bordit: Duhet të siguroj që të gjitha shpenzimet buxhetohen, realizohen dhe raportohen në përputhje me Legjislacionin në fuqi. Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj prezantimin e drejtë dhe të plotë të informatave në pasqyra financiare lidhur me shpalosjen e detyrimeve kontingjente. Gjithashtu, duhet vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV-ve për vitin 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj pasqyrave financiare vjetore janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.	- Bordi i Drejtorëve; - Menaxhmenti i AKP-së; - Departamenti i Financave dhe Buxhetit.	31 dhjetor 2018	Ky rekomandim veçse është adresuar me hyrjen në fuqi të ligjit nr.06/L-023 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-34 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr.04/L-115 dhe me ligjin nr.05/L-080. Më konkretisht, Neni 16 i këtij ligji e përcakton mënyrën e kompensimit të Ofruesve të Shërbimeve Profesionale dhe shpenzimeve tjera të likuidimit. Edhe pse prej vitit 2012, ZKA e ka kualifikuar opinionin lidhur me PFV-të e Fondeve në Mirëbesim, përmes ndryshimeve të këtij ligji, konfirmohet tani edhe formalisht mënyra të cilën e kishte praktikuar AKP-ja lidhur me kompensimin e OSHP-ve përgjatë këtyre viteve. Po ashtu, si pjesë e adresimit të plotë të këtij rekomandimi është edhe fakti se, Departamenti Ligjor ka siguruar një prezantim të drejtë dhe të plotë të informatave lidhur me detyrimet kontingjente
2.	3.2.1	13	Të hyrat nga qiratë	Kryesuesi i Bordit: Duhet të siguroj ripërtëritjen e kontratave me qëllim që shfrytëzimi i aseteve të NSH-ve të bëhet konform kontratave valide dhe në bazë të rregullores së brendshme për qiratë.	- Menaxhmenti; - Autoritetet e Likuidimit; - Departamenti i Koordinimit Rajonal.	31 dhjetor 2018 (Në vazhdimësi)	
3.	3.3	14	Pagesat / shpërndarjet e 20% të punëtorëve të transferuar në BSPK	Kryesuesi i Bordit: Duhet të sigurohet se pas përfundimit të procedurave relevante të ankesave të bëhet shpërndarja e plotë e 20% që ju takon punëtorëve pas çdo shitje të aseteve të NSH-ve.	-Menaxhmenti; -Komisioni i Listave të 20% të Punëtorëve. -Departamentet dhe Njësitë përkatëse brenda AKP.	31 dhjetor 2018 (Në vazhdimësi)	
4.	4.	16	Progresi në zbatimin e rekomandimeve	Kryesuesi i Bordit: Duhet të rishikoj dhe analizoj shkaqet e rekomandimeve që janë në proces të zbatimit, dhe të përcaktojë një afat të ri kohor për zbatimin e plotë të tyre, përfshirë edhe stafin llogaridhënës. Zbatimi duhet të monitorohet në vazhdimësi.	-Menaxhmenti; -Departamenti i Financave dhe Buxhetit; -Departamenti i Koordinimit Rajonal; -Njësia e Kontrollit dhe Mbikëqyrjes.	31 dhjetor 2018 (Në vazhdimësi)	Menaxhmenti përgjatë gjithë vitit e bën azhurnimin e planeve të adresimit të rekomandimeve të ZKA-së. Po ashtu, në vazhdimësi bëhet edhe monitorimi i zbatimit të këtyre planeve.

19. STRUKTURA ORGANIZATIVE E AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

versioni:
25 Korrik 2018



20. SHTOJCAT E RAPORTIT FINANCIAR

20.1 Neni 6.1 – Lista e ndërmarrjeve nën Administrim Direkt;

20.2 Neni 9 – Përmbledhja e transaksioneve sipas valëve;

20.3 Pjesa Tekstuale e Raportit financiar sipas formatit të Komisionit për Buxhet dhe Financa të Kuvendit të Kosovës (shtojcë);

20.4 Pjesa tabelare e raportit financiar sipas formatit të Komisionit për Buxhet dhe Financave të Kuvendit të Kosovës (shtojcë);

